



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute

DREJTËSIA NË ZGJEDHJET 2014

**RAPORT RRETH PËRGJIGJES SË ORGANEVE TË DREJTËSISË NDAJ KRYERSVE TË
VEPRAVE PENALE KUNDËR TË DREJTAVE TË VOTIMIT**

Prishtinë, gusht 2014

Autor: Betim Musliu

Ekipi i hulumtuesve:

Genc Nimoni, Hulumtues

Erëlehta Popaj, Hulumtuese

Herëza Sefaj, Asistente e hulumtimeve

Përparim Haliti, Asistent i hulumtimeve

Vatra Qehaja, Asistente e hulumtimeve

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

RRETH PROJEKTIT (www.kli-ks.org/zgjedhjet-2014/)

Instituti i Kosovës për Drejtësi, po zbaton projektin “Iniciativa për ngritje të efikasitetit të organeve të drejtësisë për proces zgjedhor të lirë, drejtë dhe demokratik”, i cili ka për qëllim që të forcojë kapacitetet dhe rrisë bashkëpunimin me organet e drejtësisë në luftimin e efektiv të çfarëdo lloji krimi që pengon procesin e lirë, të drejtë dhe të besueshëm zgjedhor në Kosovë. Ky projekt mbështetet nga Ambasada Britanike në Prishtinë.

Ky projekt udhëhiqet nga Betim Musliu bashkë-autor i raporteve analitike të vetme vendore, të cilat kanë trajtuar përgjigjen e organeve të drejtësisë ndaj krimeve të zgjedhjeve. IKD gjatë këtij projekti ka mbështetur organet e ndjekjes në trajnim dhe ofrim të këshillave rreth ndjekjes efikase të krimeve të zgjedhjeve, sensibilizimin e opinionit rreth krimeve të zgjedhjeve, mbikëqyrjen e përgjigjes së organeve të drejtësisë sa i përket krimeve të zgjedhjeve, si dhe përpilimin e raporteve të cilat kanë dhënë rekomandime konkrete për të përmirësuar funksionimin e organeve të drejtësisë në të ardhmen.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Hyrja 13-A, Nr.10

Rr. Rexhep Luci

Prishtinë

T: +381 38 73 34 90

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Gusht 2014

Prishtinë, Republika e Kosovës

përkrahur nga:



British Embassy
Pristina

Përmbajtja:

1. Përmbledhje ekzekutive.....	6
2. Hyrje	8
3. Metodologjia.....	10
4. Korniza ligjore për veprat penale kundër të drejtave të votimit	11
5. Roli proaktiv i organeve të ndjekjes	12
a. Bashkëpunimi ndër-institucional	12
b. Sensibilizimi i publikut për rreziqet dhe pasojat e krimeve të zgjedhjeve	14
6. Rastet e iniciuara dhe hetimet penale rreth zgjedhjeve 2014	16
a. Monitorimi i reagimeve të organeve të drejtësisë në ditën e votimit.....	20
b. Reagimi i drejtësisë në informacionet për mbushje të kutive në fshatrat e Skënderajt	21
c. Problemet në koordinim në mes të Prokurorisë, Policisë dhe KQZ-së.....	23
d. Votimi më shumë se një herë apo për tjetrin	25
e. Pengimi i procesit votues	26
f. Të gjeturat teknike	28
7. Trajtimi i rasteve të zgjedhjeve të vitit 2013 dhe 2010	29
8. Rekomandimet.....	31

Shkurtesat

DnV	Demokracia në Veprim
ENEMO	Rrjeti Evropian i Organizatave për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
EULEX	Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit në Kosovë
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KQZ	Këshilli Qendror i Zgjedhjeve
MBEVZ	Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
PK	Policia e Kosovës
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit
PSH	Prokurori i Shtetit
PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
PTh	Prokuroria Themelore

1. Përmbledhje ekzekutive

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) është organizata e vetme e cila ka monitoruar ekskluzivisht përgjigjet e institucioneve të drejtësisë në lidhje me veprat penale kundër të drejtave të votimit qysh prej majit 2014 deri në publikimin e këtij raporti. IKD vlerëson qasjen, standardin dhe angazhimin e organeve të sigurisë dhe ndjekjes në lidhje me veprimtarinë penale kundër të drejtave të votimit. Në bazë të monitorimit të përgjigjeve të Prokurori të Shtetit (PSH) dhe Policisë së Kosovës (PK), rezulton se këto institucione kanë shënuar progres, gjithnjë duke krahasuar hetimin dhe ndjekjen e krimeve në zgjedhjet lokale 2013, zgjedhjet parlamentare 2010 dhe zgjedhjeve të organizuara përpara kësaj date.

Institucionet e drejtësisë kanë avancuar bashkëpunimin ndër-institucional, duke nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi në mes të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), PK-së, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). Si rezultat i këtij memorandumi, janë avancuar Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) në mes të PSH-së dhe PK-së. IKD vlerëson se PSV-të kanë saktësuar veprimet për hetim dhe ndjekje efikase të veprave që ndërlidhen me zgjedhjet dhe kanë qenë trangu i suksesit për t'i dhënë përgjigje adekuate rasteve të manipulimit të zgjedhjeve.

Për ditën e votimit më 8 qershor 2014, janë angazhuar 100 prokurorë dhe mbi 300 punonjës staf mbështetës si dhe mbi 5500 policë për të siguruar mbarëvajtjen e procesit të votimit. PSH ka caktuar prokuror kujdestar në Grupin Punues të vendosur në Prokurori të Shtetit, në qendrat lokale dhe në KQZ. IKD ka angazhuar 40 monitorues mobil, të cilët kanë monitoruar aktivitetet e organeve të drejtësisë në ditën e votimit.

Në këto zgjedhje parlamentare është përfshirë një numër minimal i personave në manipulimin e zgjedhjeve, gjithnjë krahasuar me zgjedhjet e vitit 2013 dhe 2010. Madje, në Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt nuk është shënuar asnjë rast i keqpërdorimit të zgjedhjeve. PTh në Prishtinë rezulton se ka pasur më së shumti raste të inicuar, gjithsejt 5 raste me 12 persona. Pas Prishtinës, pason PTh në Gjakovë, e cila ka pasur 3 raste me 5 persona, PTh në Mitrovicë, e cila ka pasur 2 raste me 3 persona, PTh në Pejë, e cila ka pasur 2 raste me 2 persona dhe PTh në Prizren, e cila ka pasur 1 rast me 1 person. Prej 23 personave të përfshirë në manipulimin e zgjedhjeve, 14 persona janë ndaluar me urdhër të prokurorëve. Ndaj 7 personave, prokurorët kanë kërkuar caktimin e masës së paraburgimit, ndërsa gjykata ka aprovuar kërkesat ndaj 5 personave, ndërsa ndaj 2 personave ka caktuar masën e arrestit shtëpiak dhe paraqitjes në stacionin policor, të tjerët janë lëshuar në procedurë të rregullt. Këta persona, sipas kallëzimeve penale, janë përfshirë në kryerjen e gjashtë veprave penale kundër të drejtave të votimit, prej gjithsejt 11 sa janë në total.

Pavarësisht se nuk kanë ndikuar në mbarëvajtjen e procesit të zgjedhjeve dhe aktiviteteve të institucioneve të drejtësisë, IKD gjatë monitorimit ka gjetur probleme në koordinimin e policisë, prokurorisë dhe KQZ-së në rastin e reagimit në disa fshatra të Skënderajt. Raportimet publike në orët e vona se po mbushen kutitë e votimit në disa fshatra në Skënderaj kanë alarmuar institucionet e drejtësisë, të cilat kanë reaguar në kohë reale. Megjithatë, në këtë rast janë

evidentuar probleme në koordinim në mes të policisë, prokurorisë dhe KQZ-së rreth mandatit ligjor për ndërrimin e komisionerëve në vendvotime. IKD vlerëson se akterët e këtyre institucioneve duhet të informohen për rolin dhe mandatin e tyre, në mënyrë që të evitohen paqartësitë, të cilat mund të kenë ndikim negativ në procesin e zgjedhjeve. Monitorimi i IKD-së dëshmon se veprimet e organeve të drejtësisë kanë qenë adekuate, duke intervistuar të gjithë komisionerët e fshatrave Tërnavc, Llaushë, Açarevë, Kopoliq dhe Turiqevc të Komunës së Skënderajt. Rreth aktiviteteve të organeve të drejtësisë në këto fshatra, PSh ka mbajtur të informuar publikun në kohë reale, duke lëshuar pas çdo një ore komunikatë për media për progresin në zbulimin e rastit.

Në ditën e votimit, monitoruesit e IKD-së gjithashtu kanë identifikuar raste kur qytetarët më të drejtë vote, kanë provuar të votonin me shumë se një herë apo raste kur persona të ndryshëm kanë provuar të votonin për personin tjetër. Ka pasur raste të regjistruara kur kandidatët për deputet në Kuvendin e Kosovës nga subjekte të ndryshme politike, kanë qenë të pranishëm nëpër qendra të votimit. Poashtu janë vërejtur raste të aktiviteteve të militantëve të partive politike në kundërshtim me rregullat zgjedhore, por të cilët ishin ndaluar dhe intervistuar nga Policia dhe Prokuroria.

Pas përfundimit të ditës së votimit, njëjtë sikurse në zgjedhjet lokale të vitit 2013, KQZ ka deponuar një numër të kallëzimeve penale për personat e përfshirë në manipulimin e zgjedhjeve të 8 qershorit 2014. Në Prokurori të Shtetit janë deponuar kallëzime penale ndaj 32 personave, të dyshuar për kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit. Megjithatë, për këto zgjedhje ende nuk ka asnjë aktakuzë të ngritur ndaj këtyre personave të denoncuar.

Në përgjithësi, rezultatet pozitive të treguara në koordinimin ndërmjet institucioneve të drejtësisë kanë ndikuar drejtpërdrejtë në mbarëvajtjen e përgjithshme të zgjedhjeve, të cilat janë vlerësuar si nga vendorët ashtu dhe nga ndërkombëtarët si zgjedhjet më të mira të organizuara pas luftës në Kosovë.

Veprat penale që ndërlidhen me zgjedhjet janë mjaftë të ndërlikuara dhe se format e ndryshme që ekzistojnë në Kosovë krijojnë hapësirë për manipulime që paraqesin sfida të madhe për organet e drejtësisë. IKD vlerëson se në fokus të organeve të ndjekjes duhet të jenë aktivitetet e financimit të partive politike.

Përgjigja sa më adekuate e organeve të drejtësisë ndaj manipuluesve të zgjedhjeve ka ndikuar dukshëm në uljen e rasteve dhe personave të përfshirë në kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit. Derisa për zgjedhjet e vitit 2010 Prokurori i Shtetit kishte akuzuar mbi 1500 persona të përfshirë në manipulimin e zgjedhjeve, në zgjedhjet e vitit 2013 kishte inicuar raste ndaj 261 personave, ndërsa ky numër është ulur dukshëm në zgjedhjet parlamentare 2014, ku janë përfshirë 23 persona.

IKD përveç monitorimit, sikurse në zgjedhjet lokale 2013 edhe zgjedhjet parlamentare 2014, në vazhdimësi ka përkrahur Koordinatorin Nacionalë për zgjedhje në PSh në përgatitje për të siguruar hetim dhe ndjekje efikase, përfshi thellimin e bashkëpunimit ndër-institucional, ngritjen

e standardit të hetimeve, thellimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të drejtësisë dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës, përmes sensibilizimit të opinionit në lidhje me format e bashkëpunimit për të parandaluar dhe luftuar kryesit e veprave penale kundër të drejtave të votimit, të cilat kanë sjellë rezultate konkrete që rezultuan me mbarëvajtjen e duhur të zgjedhjeve.

2. Hyrje

Kosova vazhdon të përballet me probleme serioze në fushën e sundimit të ligjit, e cila përbën një nga fushat më problematike të qeverisjes në vend. Sistemi i drejtësisë në Kosovë që nga përfundimi i luftës në vitin 99', vazhdimisht është anatemuar si nga misionet ndërkombëtare ashtu edhe nga pushtetet tjera vendore. Problemet kryesore të sistemit të drejtësisë ndërlidhen me jo-efikasitetin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial për shkak të problemeve të shumta objektive dhe subjektive. Anatemimi i këtyre dy sistemeve ka bërë që mos të ketë kushte elementare për punë, mos të ketë numër të mjaftueshëm të gjykatësve dhe prokurorëve dhe statusi i këtyre bartësve të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale të denigrohet deri në maksimum. Gjatë gjithë këtyre viteve sistemi i drejtësisë ka qenë cak i pushtetit ekzekutiv, që përmes anatemimit të pushtetit gjyqësor, ka krijuar një sistem të brishtë të drejtësisë, për tu ndikuar lehtësisht.

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës ka filluar të shënojë progres në aspektin formal, ku akti më i lartë juridik i vendit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ka bërë ndarjen e pushteteve dhe ka krijuar një pavarësi të madhe për pushtetin gjyqësor dhe prokurorial. Megjithatë, këto ndryshime nuk kanë arritur që ta zbusin numrin e grumbulluar të lëndëve në gjykata. Në vitin 2014 kemi mbi 400.000 lëndë të pazgjidhura, që dëshmojnë për një jo-efikasitet të sistemit të drejtësisë. Sistemi i drejtësisë ka qenë në reformë të vazhdueshme që prej krijimit të gjyqësorit emergjent pas përfundimit të luftës në Kosovë. Reformat e thella janë bërë me legjislacionin penal në vitin 2004, ndërsa reforma substanciale janë bërë me hyrjen në fuqi të Kushtetutës dhe me krijimin e ligjeve bazike të sistemit të drejtësisë, përmes të cilave u bë rikonstruktimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë. Nga sistemi i vjetër gjyqësor dhe prokurorial, sistemi i drejtësisë ka kaluar në strukturë dhe organizim të ri të sistemit të gjykatave dhe prokurorive. Megjithatë, sistemi i drejtësisë në Kosovë vazhdon të përballet me mungesë të efikasitetit për ndjekje dhe gjykim të veprave penale.

Kosova pas përfundimit të luftës ka organizuar disa palë zgjedhje të nivelit lokal dhe qendror. Problemet në mbarëvajtjen e zgjedhjeve kanë krijuar shpeshherë institucione me legjitimitet të kontestuar. Në këtë drejtim janë një seri e veprave penale, të cilat ndërlidhen me manipulimin e zgjedhjeve. Padyshim se pasojat e manipulimit të zgjedhjeve në Kosovë kanë pasur ndikim të madh negativ së pari në humbjen e besimit në organet e drejtësisë, humbjen e besimit të qytetarëve në procesin e zgjedhjeve, legjitimitetin e brishtë të institucioneve, dëmtimin e institucioneve dhe buxhetit, si dhe dëmtimin e imazhit të vendit.

Kulmi i manipulimeve në zgjedhjet e organizuara në Kosovë është shënuar në vitin 2010, ku janë mbajtur zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Kosovës. Në këto zgjedhje kishte manipulim enorm me votat e qytetarëve, të cilat dërguan vendin në disa qendra në rivotim. Për të sanuar dëmet e mëdha të cilat u konstatuan, Komision Qendror i Zgjedhjeve kishte organizuar rivotim të plotë dhe të pjesshëm në gjashtë (6) komuna, ndërsa ishin rinumëruar 890 vendvotime.

Për këtë manipulim masiv të votave në vitin 2010, padyshim se një pjesë të përgjegjësisë e bartin sistemi gjyqësor dhe sistemi prokuroria. Manipulime të zgjedhjeve janë evidentuar në zgjedhjet e vitit 2007 dhe 2009, por meqë sistemi i drejtësisë nuk ka arritur t'i ndëshkojë këto krime, manipuluesit ishin stimuluar tejmas dhe kjo ndikuar që të kemi rezultatin e zgjedhjeve të vitit 2010. Në këtë vit, Gjykata Supreme dhe Prokurori i Shtetit kishin shpallur prioritet ndjekjen dhe gjykimin e rasteve që ndërlidhen me krimet e zgjedhjeve. Për këto zgjedhje sistemi i drejtësisë për herë të parë ka filluar t'i jap përgjigje më adekuate manipuluesve të zgjedhjeve. Prokurorët akuzuan mbi 1500 komisionerë të përfshirë në këto manipulime, ndërsa gjyqësori fillimisht kishte një politike joadekuate të dënimeve, duke shqiptuar dënime me gjobë dhe kusht, por pas kritikave të shumta, gjykatësit në shkallë të dytë, filluar të korrektojnë vendimet e gjykatave të shkallës së parë,¹ duke i konvertuar gjobat në dënime me burgim efektiv.² IKD vazhdimisht ka kërkuar që krimet e kryera në zgjedhjet e vitit 2010 të hetohen dhe ndiqen si Krim i Organizuar, gjithnjë duke vlerësuar se janë plotësuar elementet e kësaj vepre penale.

Sado i vonshëm, reagimi i organeve të drejtësisë në ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të manipulimit të zgjedhjeve të vitit 2010, ka ndikuar për edukim të të gjithë publikut rreth pasojave ligjore sa i përket përfshirjes në manipulimin e zgjedhjeve.

Në këtë drejtim, për të dëshmuar gatishmëri të lartë të institucioneve të drejtësisë, për zgjedhjet lokale të vitit 2013, me iniciativë të Kryeprokurorit të Shtetit, z. Ismet Kabashi, më 18 shtator 2013 ishte nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi në mes të KPK, KGJK, PK, KQZ dhe PZAP.³ Duhet theksuar se kjo iniciativë ishte ndërmarrë nga institucionet vendore dhe se ishte ndër të rrallat, duke pasur parasysh se iniciativat për sundim të ligjit më shumë shihen si iniciativa të komunitetit ndërkombëtarë. Qëllim i këtij memorandum, ishte ngritja e bashkëpunimit dhe koordinimit në mes të institucioneve të drejtësisë, në ndërmarrjen e

¹ *Shënim:* Sipas të dhënave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për rastet e zgjedhjeve të vitit 2010, rezultoi se gjykatat kanë zgjidhur 97 lëndë ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 135 tjera. Dënimet e shqiptuara nga gjykatësit janë 30 raste dënim me burgim, 35 raste me gjobë, 9 me kusht, 1 dënim tjetër, 5 raste aktgjykim lirues, 4 raste aktgjykim refuzues, dhe 3 raste janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

² *Shënim:* Për rastet e vitit 2010 prokurorët kanë ngritur akuza për 232 raste ndaj 1,456 personave dhe se në proces të ngritjes së aktakuzave janë edhe 758 komisionerë të tjerë. QNR kishte nxjerrë nga auditimi i 890 vendvotime se në 712 vendvotime kishin pasur shumë gabime të cilat tejkalonin marzhën e gabimeve të thjeshta. Në gjithë këto vendvotime gabimet janë bërë nga 5,000 komisionerë, të cilët në vende të ndryshme, në kohë të njëjtë kanë vepruar njëjtë. Dështimi për të hetuar krimin e organizuar në zgjedhje ndërlidhet ngushtë edhe me dështimin e prokurorëve për të hetuar financimin e dyshimtë të partive politike, dështimin e materialeve zgjedhore dhe të listat e pasakta të votuesve. Të gjitha këto krime kanë kaluar pa u ndëshkuar.

³ *Memorandum Bashkëpunimi në mes të KGJK, KPK, PK, KQZ, dhe PZAP, lidhur me zgjedhjet 2013, 18 shtator 2013.*

aktiviteteve për luftim të suksesshëm të veprave penale kundër të drejtave të votimit, përfshirë edhe parandalimin e këtyre veprave penale që bien ndesh me ligjin.

IKD thekson se zgjedhjet lokale ishin ato që përfundimisht dhanë mundësi dhe dëshmuar rolin dhe fuqinë e institucionit të Prokurorit të Shtetit në Republikën e Kosovës. Opinioni publik për herë të parë është niftuar më për së afërmi me mandatin dhe fuqinë e Prokurorit të Shtetit, ashtu siç përcaktohet në Kushtetutë dhe ligje⁴. Në drejtim të krijimit të marrëdhënies së veçantë me publikun, ka dhënë kontribut të çmueshëm IKD. Kjo e fundit, në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit, ka organizuar një fushatë sensibilizimi gjithëpërfshirëse që nga fillimi i fushatës elektorale, në lidhje me rolin e institucioneve të drejtësisë, rrezikun dhe pasojat e veprave penale kundër të drejtave të votimit.⁵ Sensibilizimi i publikut, ka ngritur bashkëpunimin e institucioneve me qytetarët, të cilët në ditën e zgjedhjeve nuk kanë hezitur të raportojnë për shumë raste tek organet e ndjekjes.

Praktika e ndërtuar me zgjedhjet lokale të vitit 2013, ka vazhduar edhe për zgjedhjet parlamentare të vitit 2014. Sërish me iniciativë të Kryeprokurorit të Shtetit, z. Ismet Kabashi, pothuajse është përsëritur roli proaktiv i institucioneve të drejtësisë në parandalimin dhe luftimin e manipuluesve të votave. Me 15 maj 2014, sërish është nënshkruar Memorandum i Bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të drejtësisë dhe janë avancuar Procedurat Standarde të Veprimit, duke u bazuar në përvojën e zgjedhjeve lokale të vitit 2013. Bashkëpunimi me IKD-në ka vazhduar edhe për këto zgjedhje, për të cilat IKD ka përkrahur dhe monitoruar Koordinatorin Nacional për zgjedhje dhe ka monitoruar aktivitetet e institucioneve të drejtësisë përgjatë gjithë procesit të zgjedhjeve.

3. Metodologjia

Pas Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të institucioneve të drejtësisë për zgjedhjet parlamentare 2014, IKD dhe PSh kanë nënshkruar Memorandum të Bashkëpunimit për disa fusha.⁶ Në përputhje e obligimet e këtij memorandumi, IKD ka monitoruar përgjigjen e organeve të drejtësisë ndaj ankesave të qytetarëve dhe zyrtarëve të caktuar rreth dyshimeve për vepra

⁴ Shënim: ID vlerëon se në Kosovës që prej përfundimit të luftës, të gjitha aktivitetet në fushën e ndjekjes janë paraqitur nga Policia e Kosovës. Ky institucion për secilin aktivitet të tij, ka paraqitur rezultatet para publikut, të cilat janë përceptuar nga publiku si punë të kryera nga Policia e Kosovës, pavarësisht faktit se ky institucion kryen punët operative, ndërsa urdhërat dhe vendimet merren prej institucionit të Prokurorit të Shtetit. Kjo qasje prej përfundimit të luftës ka lënë nën hije rolin e prokurorit në Kosovë dhe ky rol pothuajse është zëvendësuar nga policia para publikut.

⁵ Përveç hartimit dhe miratimit të PSV-ve, të cilat e mundësojnë një qasje dhe standard tepër profesional të organeve të ndjekjes, Koordinatorja Nationale ka organizuar trajnime për prokurorët, është angazhuar në sensibilizimin e opinionit duke bashkë-organizuar me IKD-në shtatë debate në qendrat kryesore të vendit së bashku me përfaqësuesit e Prokurorisë Themelore në qendrat përkatëse si dhe përfaqësuesit e policisë, gjyqësorit, KQZ-së, PZAP-it, partive politike, shoqërisë civile dhe mediae. Shoqëria civile ka kontribuar në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve dhe sidomos komisionerëve të partive politike sa i përket ndryshimeve në Kodin Penal si dhe angazhimit të institucioneve shtetërore për të hetuar dhe ndjekur rastet e manipulimit të zgjedhjeve.

⁶ Memorandum Bashkëpunimi në mes të Prokurorit të Shtetit dhe Institutit të Kosovës për Drejtësi, Prokurori i Shtetit, 16 maj 2014.

penale kundër të drejtave të votimit. Ky monitorim ka përfshirë periudhën prej 16 majit 2014, deri tani.

Më 8 qershor në ditën e votimit për zgjedhjet parlamentare 2014, IKD ka pasur 40 monitorues mobil në të gjitha komunat e Kosovës, si dhe monitorues në qendër, përfshirë qendrën e ngritur nga Koordinatorja Nacionale për zgjedhje. IKD përveç monitoruesve në teren ka ngritur Qendrën e Monitorimit në zyrat e IKD-së, në të cilën janë raportuar në kohë reale të gjithë gjetjet gjatë monitorimit të aktiviteve të policisë dhe prokurorisë në teren. Monitoruesit e IKD-së gjatë monitorimit në raste të caktuara, kur kanë hasur në shkelje ligjore që ndërlidhen me veprat penale kundër të drejtave të votimit, kanë njoftuar organet e drejtësisë, të cilat kanë reaguar në kohë reale. Në fund të procesit të ditës së votimit, monitoruesit kanë përgatitur raportet me gjetjet e tyre gjatë monitorimit, të cilat më pas janë sistemuar në bazën e të dhënave në IKD për tu analizuar shkeljet karshi dispozitave ligjore.

IKD në përputhje me memorandimin në vazhdimësi ka përkrahur dhe monitoruar punën e Koordinatorës Nacionale për zgjedhjet 2014 në PSH në përgatitjet për të siguruar hetim dhe ndjekje efikase, përfshirë këtu thellimin e bashkëpunimit ndër-institucional, ngritjen e standardit të hetimeve, si dhe thellimin e bashkëpunimit në mes të organeve të drejtësisë dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës përmes sensibilizimit të publikut dhe shtrirjes së dorës për bashkëpunim të mirëfilltë.

4. Korniza ligjore për veprat penale kundër të drejtave të votimit

Kodi Penal i Republikës së Kosovës ka mundësuar ndjekje dhe gjykim adekuat të të gjitha llojeve të manipulimeve në zgjedhje. Ndryshimi dhe plotësimi i Kodit Penal, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, ka specifikuar deri në detaje veprat penale kundër të drejtave të votimit, duke ia kushtuar një kapitull të veçantë. Në Kodin e vjetër Penal të Kosovës, këto vepra ishin të përcaktuara në Kapitullin XVI “Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut”.⁷ Në Kodin e ri Penal ekziston një kapitull i veçantë, i cili përmban 11 vepra penale kundër të drejtave të votimit.⁸ Duke u bazuar në kontekstin e Kosovës dhe përvojat e kaluara me veprat penale të

⁷*Shënim:* Kodi i vjetër Penal i Republikës së Kosovës ishte baza e legjislacionit penal për sanksionimin e veprimeve kriminale në zgjedhje, i cili u kishte kushtuar një rëndësi të veçantë këtyre veprave, të cilat përcaktoheshin në nenet 176, 177, 178, 179, 180 dhe 181. Këto nene sanksionojnë veprimet kriminale ndaj të gjithë personave të cilët në çfarëdo mënyre pengojnë votuesit që të ushtrojnë të drejtën e votës, ndërmarrin çfarëdo veprimtarish korruptive, përdorin dhunë në ditën e votimit, votojnë disa herë të njëjtit votues, zbulojnë votën e fshehtë, mashtrojnë në votime dhe asgjësojnë në forma të ndryshme dokumentet e votimit. Dënimet e parapara në këto dispozita ligjore parashohin dënime me gjobë, kusht dhe burgim efektiv deri në pesë (5) vjet. *Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kapitulli XVI: Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut*, Kuvendi i Republikës së Kosovës, prill 2003.

⁸ Avancimi i legjislacionit penal në këtë drejtëm përkufizon veprimet kriminale kundër të drejtave të votimit që ndërlidhen me: cenimin e së drejtës për të kandiduar, kanosjen e kandidatit, parandalimin e ushtrimit të së drejtës për të votuar, cenimin e përcaktimit të lirë të votuesve, keqpërdorimin e detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve, dhënien ose marrjen e ryshfetit në lidhje me votimin, keqpërdorimin e të drejtës së votimit, pengimin e procesit të votimit, cenimin e fshehtësisë së votimit, falsifikimin e rezultateve të votimit, asgjësimin e dokumenteve të votimit.

zgjedhjeve, në Kodi i ri Penal janë ashpërsuar dënimet për veprat penale kundër të drejtave të votimit, duke i kategorizuar si krime të rënda.

Kodi i ri ka sanksionuar në tri faza përgjatë procesit të zgjedhjeve të gjitha veprimet kriminale, duke përfshirë vepra penale që mund të kryhen para ditës së votimit, gjatë ditës së votimit dhe pas ditës së votimit.⁹ Ky Kodi i ka ashpërsuar dukshëm dënimet ndaj komisionerëve të zgjedhjeve, dënimet ndaj të cilëve janë.¹⁰

5. Roli proaktiv i organeve të ndjekjes

IKD në përgjithësi sikurse për zgjedhjet lokale të vitit 2013, edhe për zgjedhjet parlamentare 2014, vlerëson qasjen dhe standardin e PSH-së në trajtimin me prioritet të rasteve të zgjedhjeve, gjithnjë duke krahasuar trajtimin e këtyre rasteve nga këto institucione në të kaluarën. Ky rol proaktiv dhe reagimet adekuate të institucioneve të drejtësisë rreth procesit të zgjedhjeve parlamentare ka ndikuar në vlerësimet pozitive nga institucioneve relevante vendore dhe ndërkombëtare, subjektet garuese në zgjedhje si dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare që kanë monitoruar ditën e votimit më 8 qershor.¹¹

a. Bashkëpunimi ndër-institucional

Edhe pse e vonuar përgjigja e organeve të drejtësisë për zgjedhjet e vitit 2010, në të cilat u shënuan manipulimet më të mëdha me vota, padyshim se ka ndikuar tek manipuluesit e zgjedhjeve, të cilët në zgjedhjet lokale të vitit 2013 ishin në numër mjaftë të vogël gjithnjë duke krahasuar me numrin e përfshirë në zgjedhjet e vitit 2010. Ngritja e aktakuzave nga PSh ndaj rreth 1500 personave, kryesisht komisionerë të partive politike, ka ndikuar në zbrapsjen e

⁹ Shënim: Veprat penale nga kapitulli XVIII, “Veprat penale kundër të drejtave të votimit” mund të kryhen përgjatë gjithë procesit të zgjedhjeve, duke përfshirë veprimet kriminale para, gjatë dhe pas ditës së votimit. Disa nga veprat penale që mund të kryhen në përgatitje të zgjedhjeve sanksionohen në nenet 210 “Cenimi i së drejtës për të kandiduar” dhe 211 “Kansosja e kandidatit”. Disa nga veprat penale që mund të kryhen në përgatitje dhe në ditën e zgjedhjeve sanksionohen në nenet 212 “Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar”, neni 214 “Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve” dhe neni 215 “Dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin”. Disa nga veprat penale që mund të kryhen në ditën e zgjedhjeve sanksionohen në nenet 213 “Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve”, 216 “Keqpërdorimi i të drejtës së votimit”, neni 217 “Pengimi i procesit të votimit” dhe neni 218 “Cenimi i fshehtësisë së votimit”. Disa nga veprat penale që mund të kryhen në ditën e zgjedhjeve pas mbylljes së procesit të votimit sanksionohen në nenet 219 “Falsifikimi i rezultateve të votimit” dhe 220 “Asgjësimi i dokumenteve të votimit”.

¹⁰ Shënim: Kodi i ri përcakton vepra penale, të cilat përqendrohen te komisionerët e zgjedhjeve, ndaj të cilëve në secilin rast dënimet ashpërsohen si në vijim: Nëse veprat penale nga neni 212 dhe 218 kryhen nga komisionerët e zgjedhjeve dënimet janë minimum prej 1 deri në 5 vite burgim. Nëse vepra penale nga neni 214 kryhet nga komisionerët e zgjedhjeve dënimi është minimum prej 2 deri në 5 vite burgim. Nëse veprat penale nga nenet 215, 216, 219 dhe 220 kryhen nga komisionerët e zgjedhjeve atëherë dënimi minimal për ta është prej 3 deri në 5 vite burgim.

¹¹ Shënim: Shih vlerësimet pozitive të organizatave vendore dhe ndërkombëtare rreth mbarëvajtjes së procesit të zgjedhjeve në ditën e votimit më 8 qershor 2014. (shih - <http://www.osce.org/kosovo/119610>; http://www.eueom.eu/files/pressreleases/other/eueom-kosovo2014-preliminary-statement_sq.pdf; http://www.demokracianeveprim.org/al/index.php?subaction=showfull&id=1402268182&archive=&start_from=&ucat=1&)

manipuluesve. Reagimi efikas në IKD në publikimet e para vendore rreth ndjekjes dhe dënimeve për rastet e zgjedhjeve, pasi ka analizuar në të kaluarën dështimet në politikën e ndjekjes dhe dënimeve, ka rekomanduar një rol proaktiv të institucioneve të drejtësisë për të parandaluar dhe luftuar me sukses manipulimet e zgjedhjeve. Për dallim nga zgjedhjet e vitit 2010, Kryeprokurori i Shtetit, kishte vendosur të zbatonte një politikë proaktive për zgjedhjet e 3 nëntorit 2013, të bazuar në parandalim dhe në ndjekje proaktive të veprave penale kundër të drejtave të votimit. Duke u bazuar në legjislacionin pozitiv në Kosovë, PSh ka krijuar një bashkëpunim ndër-institucional me të gjitha institucionet relevante të drejtësisë të përfshiranë procesin e zgjedhjet 3 nëntorit 2013.¹² Rezultatet konkrete të këtij bashkëpunimi u dëshmuar gjatë gjithë procesit të zgjedhjeve 2013.

Si rezultat i Memorandumit të Bashkëpunimit, ishte caktuar Koordinatorja Nacionale për zgjedhje, për të siguruar zbatimin e Memorandumit si dhe koordinimin e të gjithë akterëve nënshkrues të këtij akti. IKD vazhdimisht ka qenë aktive në monitorimin e këtyre aktiviteteve të organeve të drejtësisë. Përgjatë bashkëpunimit të IKD-së me këto organe të drejtësisë është arritur të ndërtohet një bashkëpunim dhe komunikim i mirë, i cili ka sjellë rezultate konkrete në pasurimin e Memorandumit të Bashkëpunimit. Ky memorandum i hartuar nga PSh ishte konsultuar edhe me grupet tjera të interesit dhe ishte hapur edhe për organizata të shoqërisë civile.

IKD ka qenë vazhdimisht e përfshirë në gjithë këtë proces dhe ka dhënë kontribut të çmuar me propozimet e veta për përmbajtjen e këtij Memorandumi të Bashkëpunimit. Arritja më e madhe si rezultat i këtij bashkëpunimi rreth hartimit të Memorandumi të Bashkëpunimit ishte krijimi i PSV në mes të PSH-së dhe PK-së, të cilat kishin saktësuar veprimet për hetim dhe ndjekje efikase të veprave që ndërlidhen me zgjedhjet, gjithnjë duke u bazuar në mësimet e nxjerra nga e kaluara dhe përvojat më të mira bazuar në ligjet në fuqi. PSV-të ishin rekomandim konkret ekskluzivisht i IKD-së në procesin e hartimit dhe konsultimit të këtij akti me shoqërinë civile.¹³ Sikurse në raportet e më parshme, IKD vlerëson se PSV-të kanë qenë trangu i bashkëpunimit efikas të paparë deri më tani sa i përket hetimit dhe ndjekjes së krimeve të caktuara në Kosovë.

Zbatimi i PSV-ve me efikasitet, përgjithësisht kishte sjellë rezultatet pozitive të treguara në koordinimin ndërmjet institucioneve të drejtësisë, të cilat padyshim se kanë ndikuar drejtpërdrejtë në mbarëvajtjen e përgjithshme të zgjedhjeve, të cilat janë vlerësuar si nga

¹² *Shënim:* Kryeprokurori i Shtetit kishte ftuar organet sikurse Policinë e Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dhe Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, për të përpiluar dhe nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi për zgjedhjet 2013. *Memorandum Bashkëpunimi në mes KPK, KGJK, PK, KQZ, dhe PZAP lidhur me zgjedhjet 2013*, 18 shtator 2013.

¹³ *Shënim:* Këshilli Prokurorial i Kosovës ka ftuar organizatat e shoqërisë civile për të dhënë komente në draft-Memorandumin e Bashkëpunimit “Lidhur me zgjedhjet 2013”. Komentet ishin adresuar përmes postës elektronike dhe përmes takimeve të organizuara nga Këshilli Prokurorial me organizatat e shoqërisë civile. Në këtë fazë me iniciativën dhe propozimin konkret të IKD-së ishin krijuar Procedurat Standarde të Veprimit në mes të PSh dhe PK-së. Shtator 2013.

vendorët ashtu dhe nga ndërkombëtarët si zgjedhjet më të mira të organizuara pas luftës në Kosovë.¹⁴

Praktika e bashkëpunimit ndër-institucional e ndërtuar me zgjedhjet lokale të vitit 2013, ka vazhduar edhe për zgjedhjet parlamentare të vitit 2014. PSh dhe PK kanë pasur bashkëpunim të ngushtë në zbatimin e PSV-ve, të cilat rezultuar me veprime konkrete në rastet e paraqitura rreth procesit të zgjedhjeve. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit për ditën e votimit përveç angazhimit të 100 prokurorëve dhe mbi 300 punonjës staf mbështetës ka caktuar prokuror kujdestar në Grupin Punues të vendosur në Prokurori të Shtetit dhe qendrat lokale poashtu ka caktuar prokuror kujdestar edhe në KQZ.¹⁵ Ky grup ka qenë i qasshëm për të gjitha subjektet politike, të cilat kanë mundur të shprehin shqetësimet e tyre dhe të informojnë prokurorët për çfarëdo shkelje në lidhje me veprat penale kundër të drejtave të votimit.¹⁶ Në ditën e votimit do të vëreni probleme të caktuara në koordinimin e prokurorisë, policisë dhe KQZ-së, të cilat janë monitoruar nga IKD, por të cilat nuk kanë ndikuar në mbarëvajtjen e procesit të zgjedhjeve.

b. Senzibilizimi i publikut për rreziqet dhe pasojat e krimeve të zgjedhjeve

Instituti i Kosovës për Drejtësi në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit kanë mbajtur shtatë tryeza¹⁷ me pjesëmarrjen e të gjithë akterëve relevant të përfshirë në procesin e zgjedhjeve, në tetë qendra të Kosovës si në Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Gjilan, Ferizaj, Gjakovë dhe Pejë dhe Graçanicë¹⁸. Në këto tryeza Koordinatorja Nacionale për zgjedhje nga Prokurori i Shtetit znj. Laura Pula bashkë me Koordinatorët e shtatë Prokurorive Themelore, përfshi dhe prokurorët kujdestar të zgjedhjeve kanë proklamuar parimin kryesor të PSV-ve, për arrestim/ndalimin e të gjithë personave që përfshihen në kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit. Në secilën prej këtyre tryezave të udhëhequra nga IKD, kanë marrë pjesë rreth 50 pjesëmarrës, duke

¹⁴ Vlerësimet pozitive për këtë proces i kanë dhënë Misioni ndërkombëtar i ENEMO-së për vëzhgimin e zgjedhjeve, Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, Rrjeti i organizatave jo-qeveritare Demokracia në Veprim, njëkohësisht, përfaqësuesit e misioneve diplomatike të vendeve të ndryshme në Prishtinë si dhe Bashkimit Evropian kanë vlerësuar se Kosova është e aftë të mbajë zgjedhje të lira dhe fer, dhe se qytetarët duke raportuar raste tek organet e drejtësisë kanë treguar përkushtimin e tyre për zgjedhje të lira dhe transparente si dhe besimin tek organet e ndjekjes. Shih Musliu B., Gashi A., *Raport i shkurtër mbi përgjigjen e organeve të drejtësisë ndaj veprave penale kundër të drejtave të votimit #1* (Prishtinë: IKD, 8 nëntor 2013), f. 5 dhe 6.

¹⁵ *Shënim*: Grupet punuese të Koordinatorës Nacionale për zgjedhjet 2014. Prokurori i Shtetit. (shih http://psh-ks.net/repository/docs/Grupet_punuese_per_zgjedhjet_2014.pdf)

¹⁶ *Shënim*: Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka caktuar prokurorët kujdestar në nivel qendror dhe në nivel lokal të cilët kanë qenë të qasshëm vazhdimisht për personat e autorizuar të partive politike për të informuar rreth keqpërdorimeve të procesit të zgjedhjeve. 30 maj 2014. Prokurori i Shtetit. (shih http://psh-ks.net/repository/docs/subjekteve_politike.pdf)

¹⁷ Instituti i Kosovës për Drejtësi në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit dhe në mbështetje të Ambasadës Britanike në Kosovë kanë organizuar tryeza në tetë qendrat e Kosovës, duke përfshirë tryezën e mbajtur në Gjilan më datën 20 maj, Prizren 21 maj, Gjakovë 22 maj, Pejë 23 maj, Ferizaj 2 qershor, Mitrovicë 4 qershor, Graçanicë 5 qershor dhe Prishtinë më 6 qershor 2014. Për më tepër shih të gjitha diskutimet nga tryezat e mbajtura në këto qendra. (shih <http://kli-ks.org/zgjedhjet-2014/tryeza-2/> dhe në kanalin në youtube.com shih <https://www.youtube.com/user/betimiperdrejtesi/videos>)

¹⁸ Tryeza e mbajtur në Graçanicë është organizuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit dhe organizatat jo-qeveritare “Demokracia në Veprim”.

përfshirë të gjitha grupet e interesit që ndërlidhen me procesin e zgjedhjeve. Shpalosja e planeve konkrete të të gjitha institucioneve të drejtësisë, që kanë nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit “Lidhur me zgjedhjet parlamentare 2014” ka nxitur diskutime të shumta në tryeza, të cilat janë transmetuar në edicione speciale në Radio Televizionin Publik të Kosovës, në lajmet qëndrore të televizioneve nacionale si dhe në mediat lokale. Pas mbajtjes së tryezave IKD¹⁹ dhe PSh²⁰ ka lëshuar komunikata për media, duke përmbledhur diskutimet më interesante për të informuar publikun. Këto tryeza kanë luajtur një rol tepër të rëndësishëm që të ketë informim të publikut për rreziqet dhe pasojat që mund të bartin poqëse përfshihen në aktivitete që ndërlidhen me 11 veprat penale kundër të drejtave të votimit.²¹ Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit poashtu ka realizuar një promo, me përmbajtje informuese për përgatitjet dhe gatishmërinë e institucioneve të drejtësisë për ditën e votimit më 8 qershor 2014. Kjo promo është shfaqur vazhdimisht në mediumin publik dhe ka pasur efekt tepër pozitiv për senzibilizimin e publikut.²²

Për senzibilizimin e publikut rreth rreziqeve dhe pasojave të qytetarëve që mund të përfshihen në manipulimin e zgjedhjeve janë angazhuar edhe organizata tjera të shoqërisë civile. Gjatë kohës së fushatës zgjedhore dhe në ditën e votimit nëpër televizionet nacionale dhe private është shfaqur një reklamë e fushatës së organizuar nga KFOS “Voto dhe vëzhgo: Lajmëro çdo parregullësi”. Përmbajtja e kësaj fushate është kontestuar nga Prokurori i Shtetit, për shkak se përmes kësaj fushate është bërë thirrje që të denoncohen parregullësitë në numrin pa pagesë 50088, ndërsa ato informacione të dërguara nga qytetarët përmes mesazheve janë konsideruar private dhe Prokurori i Shtetit nuk ka pasur asnjë bashkëpunim me këtë organizatë.²³ Në kohën e mbajtjes së fushatës zgjedhore, derisa po shfaqej kjo fushatë “Voto dhe Vëzhgo”, Prokurori i Shtetit, kishte deklaruar haptas se kjo fushatë po e pengon punën e institucioneve të drejtësisë,

¹⁹ Instituti i Kosovës për Drejtësi ka informuar publikun në kohë reale në lidhje e diskutimet e zhvilluara në tryezat e organizuara në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit. IKD ka lëshuar komunikata për media rreth një orë pas mbajtjes së tryezave për të senzibilizuar publikun rreth aktiviteteve të institucioneve të drejtësisë në lidhje me zgjedhjet parlamentare 2014. (shih - <http://kli-ks.org/zgjedhjet-2014/>)

²⁰ Tryezat e organizuara nga Instituti i Kosovës për Drejtësi në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit “Drejtësia në zgjedhjet parlamentare 2014”, të publikuara në uebfaqen e Prokurorit të Shtetit. Tryeza në Mitrovicë – shih <http://psh-ks.net/?page=1,8,576>; Tryeza në Graçanicë – shih <http://psh-ks.net/?page=1,8,578>; Tryeza në Ferizaj – shih <http://psh-ks.net/?page=1,8,572>; Tryeza në Pejë – shih <http://psh-ks.net/?page=1,8,569>; Tryeza në Gjakovë – shih <http://psh-ks.net/?page=1,8,567>; Tryeza në Prizren – shih <http://psh-ks.net/?page=1,8,566>; Tryeza në Gjiilan – shih <http://psh-ks.net/?page=1,8,565>.

²¹ IKD intervistë me znj. Laura Pula, Koordinatore Nacionale për zgjedhje në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit. Korrik 2014.

²² IKD intervistë me znj. Laura Pula, Koordinatore Nacionale për zgjedhje në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit. Korrik 2014.

²³ *Shënim*: Në debatin televiziv të mbajtur në RTK1 në kuadër të debateve zgjedhore, me temën “Drejtësia në zgjedhjet parlamentare 2014”, z. Ismet Kabashi, Kryeprokuror i Shtetit dhe z. Shpend Maxhuni, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kanë deklaruar se fushata “Voto dhe vëzhgo: Lajmëro çdo parregullësi” nuk i ka ndihmuar insitucionet e drejtësisë në parandalimin dhe luftimin e kryesve të veprave penale kundër të drejtave të votimit. Të dy këta udhëheqës të institucioneve të drejtësisë, në këtë debat, kanë deklaruar se kjo fushatë ka penguar punën e këtyre institucioneve sepse ka ndikuar negativisht tek qytetarët, duke ua mjegulluar adresën e vërtetë se ku duhet të bëjnë denoncimet për keqpërdorimet e mundshme në zgjedhje.

Për më tepër shih debatin.

(shih <https://www.youtube.com/watch?v=tdpo8ItpgV&list=PLRrFsdYF5HhJJRyE9pHE9XEd31yqhfGZyI>).

pasiqë po e mjequllon adresën e vërtetë se ku duhet të denoncohen keqpërdorimet. Kjo çështje ishte bërë temë mediatike, e cila ishte trajtuar vazhdimisht nga media të shumta dhe në debate televizive.²⁴ Përfaqësuesit e kësaj fushate, në ditën e votimit, në mesditë kanë marrë një numër të madh të mesazheve, por mbi 90% të atyre që kishin dërguar mesazhe, kishin treguar procesi po shkonte në rregull.²⁵

6. Rastet e iniciuara dhe hetimet penale rreth zgjedhjeve 2014

Praktikat e mira të bashkëpunimit ndër-institucional të ndërtuara për herë të parë në zgjedhjet lokale 2013, vazhduan edhe në zgjedhjet 2014. PSh në bashkëpunim me PK-në për zgjedhjet e 8 qershorit 2014 kanë arritur t’iu përgjigjen rasteve të iniciuara për kryerjen e mundshme të veprave penale kundër të drejtave të votimit.

Në ditën e votimit me 8 qershor, Prokurori i Shtetit ka pasur të angazhuar 100 prokurorë kujdestar me mbi 300 punonjës të stafit mbështetës. Ndërsa, Policia e Kosovës ka pasur të angazhuar mbi 5500 policë në teren. Ky ka qenë përkushtimi më i madh i institucioneve të drejtësisë ndonjëherë për të angazhuar numër kaq të madh të zyrtarëve të prokurorisë dhe policisë për të siguruar mbarëvajtjen e procesit zgjedhor sa i përket aspektit të sigurisë dhe aspektit penal. Për monitorimin e aktiviteteve të këtyre institucioneve në ditën e votimit me 8 qershor, IKD ka angazhuar 40 monitorues mobil, të cilët kanë mbuluar tërë territorin e Kosovës, me përjashtim të komunave në veri të Mitrovicës.

Përgjigja sa më adekuate e organeve të drejtësisë ndaj manipuluesve të zgjedhjeve ka ndikuar dukshëm në uljen e rasteve dhe personave të përfshirë në kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit. Derisa për zgjedhjet e vitit 2010 Prokurori i Shtetit kishte akuzuar mbi 1500 persona të përfshirë në manipulimin e zgjedhjeve, në zgjedhjet e vitit 2013 kishte inicuar raste ndaj 261 personave, ndërsa ky numër është ulur dukshëm në zgjedhjet parlamentare 2014, ku janë përfshirë 23 persona.

²⁴ “Prokuroria fushatë kundër fushatës “Voto dhe vëzhgo”. Gazeta JNK. 3 qershor 2014. (shih - <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,8396>)

²⁵ “6674 SMS u dërguan tek “Voto dhe Vëzhgo”. Telegrafi.com. Publikuar në orën 15:23 minuta. (shih - <http://www.telegrafi.com/lajme/6674-sms-u-derguan-tek-voto-dhe-vezhgo-2-45955.html>)




Tabela 1 – Numri i personave të përfshirë në manipulimin e votave në tri palë zgjedhjet e fundit të mbajtura në Republikën e Kosovës

Siç vërehet nga grafikoni në tabelën 1, numri i personave të përfshirë në manipulimin e votave ka rënë dukshëm prej zgjedhjeve të mbajtura në vitin 2010. Kjo është dëshmi se përgjigja adekuate e organeve të drejtësisë, ndikon pozitivisht në të gjitha aspektet, duke filluar prej vendosjes së drejtësisë dhe senzibilizimit të qytetarëve për rreziqet dhe pasojat që bartin poqëse përfshihen në kryerjen e ndonjërisë prej 11 veprave penale kundër të drejtave të votimit.

Në ditën e votimit me 8 qershor 2014, organet policore dhe të ndjekjes, reagues me efasitet në rastet, në të cilat kishte denoncime për përfshirjen e ndonjë personi në kryerjen e ndonjë veprave penale kundër të drejtave të votimit.

Sipas të dhënave të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për dallim prej zgjedhjeve lokale 2013, ku kishte një angazhim më të madh të këtyre institucioneve në luftimin e manipuluesve të votave, në zgjedhjet parlamentare 2014, pati një numër dukshëm më të ulët të personave të përfshirë në manipulime.

Në tabelën 2 vëreni numrin e rasteve dhe personave të përfshirë në manipulime në ditën e votimit me 8 qershor për të cilët ka pasur veprime ligjore nga Prokuroritë Themelore.

Prokurori i Shtetit	Raste	Persona	Ndalim	Kërkesa për paraburgim	Paraburgim	Arrest shtëpiak	Kërkesë për paraqitje në polici	Procedurë të rregullt
Pth Prishtinë	5	12	5	2		1	1	10
PTh Pejë	2	2	1	1	1			1
PTh Gjakovë	3	5	5	4	4			1
PTh Mitrovicë	2	3	3					3
PTh Prizren	1	1	1					1
PTh Gjilan	/	/						
PTh Ferizaj	/	/						
Total:	13	23	14	7	5	1	1	16

Tabela 2 – Numri i rasteve dhe personave ndaj të cilëve janë iniciuar raste për zgjedhjet parlamentare 2014

Siç vërehet nga tabela 2, ekziston një numër minimal i përfshirë në manipulimin e zgjedhjeve 2014, gjithnjë krahasuar me zgjedhjet e vitit 2010 dhe 2013. PTh në Gjilan dhe në PTh në Ferizaj nuk kanë pasur asnjë rast të inicuar për ndonjërin prej veprave penale kundër të drejtave të votimit. PTh në Prishtinë rezulton se ka pasur më së shumti raste të inicuar, gjithsejt 5 raste me 12 persona. Pas Prishtinës, pason PTh në Gjakovë, e cila ka pasur 3 raste me 5 persona, PTh në Mitrovicë, e cila ka pasur 2 raste me 3 persona, PTh në Pejë, e cila ka pasur 2 raste me 2 persona dhe PTh në Prizren, e cila ka pasur 1 rast me 1 person. Prej 23 personave të përfshirë në manipulimin e zgjedhjeve, 14 persona janë ndaluar me urdhër të prokurorëve. Ndaj 7 personave, prokurorët kanë kërkuar caktimin e masës së paraburgimit, ndërsa gjykata ka aprovuar kërkesat ndaj 5 personave, ndërsa ndaj 2 personave ka caktuar masën e arrestit shtëpiak dhe paraqitjes në stacionin policor, të tjerët janë lëshuar në procedurë të rregullt.

Përfshirja e këtyre 23 personave në manipulimin e votave në ditën e votimit më 8 qershor 2014, sipas cilësimeve në kallëzimet penale ndërlidhet me kryerjen e 8 veprave penale kundër të drejtave të votimit, prej gjithsejt 11 sa janë në total. Për më tepër shih tabelën 3.

Prokurori i Shtetit	Total:	Neni 212 - Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar	Neni 213 - Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve	Neni 214 - Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë	Neni 215 - Dhënia ose marrja e rryshfetit në lidhje me votimin	Neni 216 - Keqpërdorimi i të drejtës për të votuar	Neni 217 - Pengimi i procesit të votimit
Pth Prishtinë	12	2			8	1	1
PTh Pejë	2						2
PTh Gjakovë	5		1	1			3
PTh Mitrovicë	3				2	1	
PTh Prizren	1						1
PTh Gjiilan							
PTh Ferizaj							
Total:	23	2	1	1	10	2	7

Tabela 3 – Personat e përfshirë në kryerjen e veprave penale sipas veprave penale dhe prokurorive

Në zgjedhjet parlamentare në ditën e votimit më 8 qershor 2014, prej 23 personave të përfshirë në manipulimin e zgjedhjeve janë 6 vepra penale për të cilat janë bërë kallëzimet penale për kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit. Siç është theksuar më lartë në këtë kapitull të veprave penale janë gjithsejt 11 vepra penale dhe sipas të dhënave të Këshillit Prokurorial, rezulton se nuk ka pasur asnjë kallëzim penal për 5 lloje të veprave penale kundër të drejtave të votimit.²⁶

Pas përfundimit të ditës së votimit, njëjtë sikurse në zgjedhjet lokale të vitit 2013, KQZ ka deponuar një numër të kallëzimeve penale për personat e përfshirë në manipulimin e zgjedhjeve të 8 qershorit 2014. Në Prokurori të Shtetit janë deponuar kallëzime penale ndaj 32 personave, të dyshuar për kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit për zgjedhjet e 8 qershorit. Kallëzimet penale për këta persona ndërlidhen me dyshimet se kanë kryer vepra penale që përfshijnë veprime si: tentim për blerje të votave, asistim për të votuar, kërcënime, zbulim i fshehtësisë së votës dhe kërcënim, manipulim me emrat e kandidatëve në listë, presion ndaj votuesve, publikimin e më pak votave se në rezultatin preliminar si dhe mos regjistrimi i votave në formularë.

²⁶*Shënim:* Janë 5 vepra penale kundër të drejtave të votimit të përcaktuara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, për të cilat nuk ka pasur asnjë denoncim në lidhje me përfshirjen e ndonjë personi në ditën e votimit me 8 qershor 2014. Këto janë veprat për të cilat nuk ka pasur asnjë denoncim: Neni 210 – “Cenim i së drejtës për të kandiduar”, Neni 211 – “Kanosja e kandidatit”, Neni 218 – “Cenimi i fshehtësisë së votimit”, Neni 219 – “Falsifikim i rezultateve të votimit” dhe Neni 220 – “Asgjësimi i dokumenteve të votimit”.

IKD vlerëson se zbatimi i PSV-ve ka rritur efikasitetin dhe efektivitetin e veprimeve të policisë dhe prokurorëve në të gjitha këto raste që ndërlidhen me veprat penale kundër të drejtave të votimit, duke bërë institucionet e sigurisë dhe ndjekjes shumë proaktive dhe duke sjellë një rezultat të tillë, ku numri i personave të përfshirë në manipulim është minimal krahasuar me zgjedhjet e kaluara.

Për dallim prej zgjedhjeve lokale të vitit 2013, ku pas disa javësh ishin ngritur aktakuza ndaj personave të përfshirë në manipulimin e zgjedhjeve, për zgjedhjet parlamentare 2014, nuk ka asnjë aktakuzë të ngritur ndaj asnjë personi ndaj të cilit është ngritur kallëzim penal. IKD vlerëson se trajtimi me vonesë i këtyre rasteve ndikon negativisht tek qytetarët, të cilët posa kanë filluar të kthejnë sadopak besimin se këto institucione të drejtësisë kanë filluar t'i japin përgjigje manipuluesve të votave. Gjithashtu, trajtimi me prioritet i këtyre rasteve tashmë është bërë përmes dokumenteve të këtyre institucioneve, të cilat duke u bazuar në dëmet e shkaktuara, kanë vendosur t'i trajtojnë me prioritet rastet e zgjedhjeve.

Megjithatë, IKD shpreh shqetësimin për politikën e ndjekjes në rastet e krimeve të zgjedhjeve. Sikurse në punimet e kaluara lidhur me krimet e zgjedhjeve, IKD vlerëson se PSH duhet të orientojë hetimet në drejtim të ndjekjes së organizatorëve të krimeve të zgjedhjeve. Veprat penale kundër të drejtave të votimit janë mjaftë të ndërlikuara dhe se format e ndryshme që ekzistojnë në Kosovë krijojnë hapësirë për manipulime që paraqesin sfida të madhe për organet e ndjekjes. Në këtë drejtim padyshim se sfida mbeten disa aspekte në të cilat organet e ndjekjes duhet të orientojnë hetimet siç është çështja e financimit të aktiviteteve të partive politike.

a. Monitorimi i reagimeve të organeve të drejtësisë në ditën e votimit

Instituti i Kosovës për Drejtësi ka monitoruar aktivitetet e organeve të drejtësisë në ditën e votimit më 8 qershor 2014 për zgjedhjet parlamentare.²⁷ IKD ka angazhuar katërdhjetë (40) vëzhgues mobil në tërë territorin e vendit²⁸, të cilët kanë monitoruar përgjigjet e organeve të drejtësisë në lidhje me veprat penale kundër të drejtave të votimit.

Monitoruesit e IKD-së kanë vërejtur një bashkëpunim të afërt në mes të institucioneve të drejtësisë dhe në shumicën e rasteve reagimi i policisë dhe prokurorëve ka qenë në pajtim me ligjin në ndjekjen e keqpërdoruesve të votave. Gjatë monitorimit të aktiviteteve të policisë, prokurorisë dhe akterëve tjerë në zgjedhje, monitoruesit kanë ndikuar në ngritjen e përgjegjësisë së tyre në zbatimin e ligjit, rrjedhimisht në luftimin e keqpërdoruesve të votave.

Gjatë ditës së votimit, monitoruesit e IKD-së kanë vërejtur lëshime të natyrave të ndryshme të policisë dhe prokurorëve, por edhe probleme të koordinimit në mes të policisë, prokurorisë dhe

²⁷ *Shënim:* IKD ka monitoruar aktivitetet e organeve të drejtësisë edhe në zgjedhjet lokale të vitit 2013. Për këto zgjedhje ka pasur të angazhuar monitorues mobil, të cilët kanë lëvizur në të gjitha komunat e Kosovës për të monitoruar aktivitetet e policisë dhe prokurorisë.

²⁸ *Shënim:* IKD nuk ka pasur monitorues për të mbuluar zgjedhjet në komunat e veriut në Mitrovicë.

zyrtarëve të KQZ-së. Gjithsesi, këto probleme nuk kanë ndikuar në mbarëvajtjen e aktiviteteve të institucioneve të drejtësisë për t'i dhënë përgjigje adekuate manipuluesve të votave.

IKD ka monitoruar deri në detaje reagimet e organeve të drejtësisë në rastin më të rëndë të raportuar në ditën e votimit më 8 qershor 2014 për mbushjen e kutive të votimit në disa fshatra të Skënderajt.

Monitoruesit e IKD-së në ditën e votimit kanë identifikuar raste kur qytetarët më të drejtë vote, kanë provuar të votonin me shumë se një herë apo raste kur persona të ndryshëm kanë provuar të votonin për personin tjetër. Ka pasur raste të regjistruara kur kandidatët për deputet në Kuvendin e Kosovës nga subjekte të ndryshme politike, kanë qenë të pranishëm nëpër qendra të votimit.

Gjatë monitorimit janë vërejtur raste të aktiviteteve të militantëve të partive politike në kundërshtim me rregullat zgjedhore. Ata ishin ndaluar dhe intervistuar nga Policia dhe Prokuroria. Tutje, janë evidentuar raste të mungesave të fletëvotimeve, probleme me llambat identifikuese - ultravjollcë, ndërprerjen e energjisë elektrike, mos-hapjen me kohë të qendrave votuese, problemet me emrat në listat votuese e të tjera.

b. Reagimi i drejtësisë në informacionet për mbushje të kutive në fshatrat e Skënderajt

Rasti më i rëndë i raportuar rreth zgjedhjeve të 8 qershorit 2014 është raportimi i organizatave të shoqërisë civile “Demokracia në Veprim” për mbushje të kutive të votimit në disa fshatra të Skënderajt. Përfaqësuesit e kësaj organizate në orën 18 kanë mbajtur një konferencë për media, në të cilën kanë deklaruar se në dy, tri fshatra në Skënderaj po mbushen e kutitë e votimit dhe kanë kërkuar reagimin e organeve të drejtësisë.²⁹ Pas këtij reagimi, PSh dhe PK kanë reaguar me urgjencë, duke dërguar prokurorët kujdestar dhe ekipet policore në Komunën e Skënderajt në fshatrat Tërnavc, Llaushë, Açahevë, Kopoliq dhe Turiqevc.³⁰ Pas arritjes në vendin e ngjarjes, organet policore dhe prokurori kujdestar kanë vëzhguar situatën në vendvotime. IKD ka monitoruar aktivitetin e policisë dhe prokurorisë në fshatin Açahevë të Komunës së Skënderajt, për të cilin u dhanë informacione se po mbusheshin kutitë e votimit.³¹ Monitorimi tregon se pas mbylljes së kutive të votimit, policia dhe prokurori kujdestar kanë filluar të marrin në pyetje

²⁹ “Selmanaj:Në Skënderaj po mbushen kutitë”. Gazeta Express. Koha e publikimit 18:13 minuta, 8 qershor 2014. (shih <http://grid.al/read/neës/158250140/7587341/selmanaj-ne-skenderaj-po-mbushen-kutite>)

³⁰ *Shënim:* IKD ka monitoruar aktivitetin e Koordinatores Nacionale për zgjedhje dhe Grupin Punues të vendosur në Prokurorin e Shtetit. Në momentin e raportimit të lajmit në konferencën e “Demokracisë në Veprim” se po mbushen kutitë e votimit në disa fshatra të Skënderajt, Koordinatorja Nacionale për zgjedhje, znj. Laura Pula ka koordinuar aktivitetet me Grupin Punues dhe Kryeprokurorin e PTh në Mitrovicë dhe janë dhënë urdhërat për të vepruar me ekipet e policisë dhe prokurorëve kujdestarë në vendin e ngjarjes.

³¹ *Shënim:* IKD ka pasur 40 monitorues mobil në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Qendra e Monitorimit të IKD-së me të marrë informacionin për raportim të mbushjes së kutive të votimit në disa fshatra të Skënderajt, ka dërguar monitoruesit mobil në këto fshatra, të cilët kanë monitoruar aktivitetet e policisë dhe prokurorisë në vendin e ngjarjes.

komisionerët e vendvotimit.³² Nga deklaratat e komisionerëve të intervistuar, rezultonte se nuk ka pasur keqpërdorim të drejtave të votimit apo mbushje të kutive të votimeve në Aqarevë, ashtu siç ishte raportuar nga “Demokracia në Veprim”. Komisionerët e intervistuar nga organet e drejtësisë i përkisnin të gjitha partive politike, të cilat kanë garuar në zgjedhje³³. Interesimi i mediave dhe qytetarëve tashmë ishte përqëndruar në ngjarjen e raportuar për mbushjen e kutive të votimit në këto fshatra të Skënderajt. Për të mbajtur të informuar publikun rreth zhvillimit të aktiviteteve të prokurorisë dhe policisë, Koordinatorja Nacionale për zgjedhje së bashku me Grupin Punues, kanë qenë në kontakte të vazhdueshme me prokurorët kujdestar dhe policinë në vendin e ngjarjes. Informacionet më të freskëta të veprimeve të organeve të drejtësisë i kanë plasuar për publikun për komunikatave për media. Kjo është një praktikë e re në punën e institucioneve të drejtësisë, gjë të cilën IKD e vlerëson lartë, për shkak të informimit të publikut në kohë reale. PSh komunikatën e parë media rreth zhvillimeve në kohë reale për dyshimet se në disa fshatra të Skënderajt po mbushen kutitë e ka lëshuar pak minuta pas orës 21:00.³⁴ Në këtë komunikatë, PSh ka njoftuar se deri në orën 21:00, sipas informacioneve të pranura nga PTh në Mitrovicë, në lidhje me disa Qendra të Votimeve të kontestuara në Komunën e Skënderaj për mbushje të kutive të votimit, janë intervistuar tridhjetë komisionerë të të gjitha partive politike dhe sipas deklaratave rezulton se nuk ka pasur keqpërdorim të drejtave të votimit apo mbushje të kutive të votimeve në këto vendvotime sikurse është raportuar nga “Demokracia në Veprim”. Komunikata e dytë³⁵ për media është lëshuar pas një orë e gjysmë, në të cilën PSh ka njoftuar se ka intervistuar të gjithë komisionerët e Qendrave të Votimeve në fshatrat Tërnavc, Aqarevë, Llaushë dhe Kopiliq në Komunën e Skënderaj pas dyshimeve të ngritura për mbushje të kutive të votimit dhe se nga intervistat rezulton se të gjithë kanë deklaruar se nuk ka pasur keqpërdorim të drejtave të votimit apo mbushje të kutive të votimeve në këto vendvotime. Komunikata e tretë për media³⁶ është lëshuar sërish pas një orë e gjysmë, ku është njoftuar publiku se janë intervistuar të gjithë komisionerët e Qendrave të Votimeve në fshatrat Tërnavc, Aqarevë, Llaushë, Kopiliq dhe Turiqevc të Komunës së Skënderajt rreth dyshimeve për mbushje të kutive të votimit. Nga deklaratat e të gjithë 76 komisionerëve të intervistuar, rezulton se të gjithë kanë

³² *Shënim:* Monitoruesi i IKD-së në fshatin Aqarevë ka raportuar në Qendrën e Monitorimit të IKD-së së në orën 20:10 minuta kanë hyrë në vendvotim në klasë dy pjesëtarë të policisë, të cilët kanë ndërprerë procesin e numërimit të votave. Sipas monitoruesit, policët kanë njoftuar komisionerët se janë me urdhër të prokurorit për ta ndërprerë procesin e votimit dhe kanë kërkuar që menjëherë të gjithë komisionerët dhe vëzhguesit të vendosin telefonat dhe aparatet tjera mbi tavolinë dhe të largohen nga tavolina e punës së numërimit të votave. Të gjithë janë larguar në qoshe të klasës me arsyetimin se dyshohet për parregullësi. Në klasë kanë qenë prezentë dy policët, komisionerët dhe vëzhguesit e partive politike, një vëzhgues nga “Demokracia në Veprim”, dy gazetarë dhe monitoruesi i IKD-së.

³³ *Shënim:* Monitoruesi i IKD-së ka raportuar se përgjatë procesit të intervistimit në fshatin Aqarevë, në vendvotim, sjelljet e policëve të cilët kanë intervistuar komisionerët e partive politike kanë qenë në përputhje me ligjin dhe tejet korrekte. Gjatë procesit të intervistimit policët nuk kanë lejuar qasje për asnjë përfaqësues prezentë në klasë as në telefonat e tyre dhe as në paisjet e tjera.

³⁴ Prokurori i Shtetit në orën 21:00 ka lëshuar komunikatën e parë media rreth zhvillimit të aktiviteteve të prokurorisë dhe policisë për të vërtetuar informacionet e raportuara për mbushje të kutive të votimit në disa fshatra të Skënderajt. Komunikatë për media. Prokurori i Shtetit. 8 qershor 2012. (shih <http://psh-ks.net/?page=1,8,584>)

³⁵ Komunikata e dytë për media. Prokurori i Shtetit. 8 qershor 2012. (shih <http://psh-ks.net/?page=1,8,586>)

³⁶ Komunikata e tretë për media. Prokurori i Shtetit. 8 qershor 2012. (shih <http://psh-ks.net/?page=1,8,587>)

deklaruar se nuk ka pasur keqpërdorim të drejtave të votimit apo mbushje të kutive të votimeve në këto vendvotime sikurse është raportuar nga “Demokracia në Veprim”. PSh ka njoftuar se më datën 9 qershor do të intervistojë vëzhguesit e “Demokracisë në Veprim” lidhur me pretendimet e bëra lidhur me këto vendvotime në fshatrat e Skënderajt.³⁷

Përfaqësuesit e “Demokracisë në Veprim” janë marrë në pyetje nga PSh rreth raportimit të tyre për të bashkëpunuar me organet e drejtësisë në drejtim të zbulimit të rastit. Përfaqësuesit e “Demokracisë në Veprim” për një kohë të gjatë kanë hezitur të ofrojnë bashkëpunim, duke mos ofruar personat të cilët kanë bërë këto denoncime për mbushje të kutive të votimit në disa fshatra të Skënderajt, pavarësisht sigurisë së ofruar nga Prokurori i Shtetit.³⁸ Ky i fundit ka njoftuar se pas një kohe përfaqësuesit e “Demokracisë në Veprim” kanë bashkëpunuar dhe kanë ofruar informacionet e nevojshme për të zhvilluar procedurat e nevojshme ligjore për zbardhjen e këtij rasti.³⁹ Deri në periudhën e publikimit të këtij raporti, rezulton se nuk ka ndonjë risi rreth zbulimit të ndonjë keqpërdorimi për mbushje të kutive të votimit në këto fshatra të Skënderajt, por as për vërtetimin e deklarimit të përfaqësuesve të “Demokracisë në Veprim”.

c. Problemet në koordinim në mes të Prokurorisë, Policisë dhe KQZ-së

Gjatë monitorimit të IKD-së në ditën e votimit, janë vërejtur lëshime, koordinim jo i mirë në raste të caktuara dhe hezitim i institucioneve për t’iu përgjigjur situatave të caktuara. IKD ka monitoruar Koordinatorin Nacional për zgjedhje dhe Grupin Punues të vendosur në PSh si dhe aktivitetet e policisë dhe prokurorisë në teren për të parë efikasitetin e tyre për të reaguar. Reagimet e institucioneve në rastin më të rëndë të raportuar për mbushje të kutive të votimit në disa fshatra të Skënderajt, padyshim se kanë qenë në fokus të monitorimit të IKD-së në ditën e votimit. Me të marrë lajmin për këtë raportim se ka mbushje të kutive të votimit, Koordinatorja Nationale për zgjedhje, Kryeprokurori i PTh në Mitrovicë, Policia e Kosovës në nivel qendror dhe KQZ janë alarmuar dhe kanë filluar veprimet konkrete në teren. Prokurorët dhe policia kanë shkuar menjëherë në vendin e ngjarjes. Fillimisht kishte pasur një vonesë të policisë për shkak të numrit të pamjaftueshëm të policëve që të shkojnë në këto fshatra. Është dashur që Kryeprokurori i PTh në Mitrovicë të kërkojë me urgjencë ndihmën e Drejtorit Rajonal të Mitrovicës në Policinë e Kosovës për të reaguar. Pas kësaj urgjence ekipet e policisë kanë arritur në të gjitha fshatrat për të cilat ka pasur raportim për mbushje të kutive me vota.⁴⁰ Pas mbylljes

³⁷ Shënim: Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës kanë miratuar Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për të reaguar me urgjencë në rastet që paraqiten dhe që ndërlidhen me 11 veprat penale kundër të drejtave të votimit. Një prej PSV-ve obligon policinë në bashkëpunim me rokurorin kujdestar që të ndalojnë të gjithë personat, personat përgjegjës dhe zyrtarët, që deklarojnë rrejshëm kryerjen e ndonjë vepre penale, në publik apo tek institucionet e zbatimit të ligjit. Kjo PSV është bërë publike për të gjithë publikun përmes tryezave dhe debateve të organizuara nga IKD në bashkëpunim me PSh në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjiilan, Prizren, Ferizaj, Gjakovë dhe Graçanicë. Për më tepër shih të gjitha tryezat e zhvilluara në këto qendra (shih <http://kli-ks.org/zgjedhjet-2014/>).

³⁸ IKD intervista me znj. Laura Pula, Koordinatorin Nacional për zgjedhje dhe me z. Shyqri Sylja, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë. Korrik-Gusht 2014.

³⁹ IKD intervistë me z. Shyqri Sylja, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë. Gusht 2014.

⁴⁰ “Fillimisht ka pas një hezitim nga Stacioni Policor në Skënderaj se nuk ka pasur policë të mjaftueshëm për t’i dërguar në këto vendvotime... Kështu jam informuar nga prokurori kujdestar, Ismet Ujkani. Dhe, menjëherë i kam

së kutive të votimit në orën 19:00 në fshatrat Tërnavc, AçaREVë, Llaushë, Kopiliq dhe Turiqevc të Komunës së Skënderajt, policia ka filluar të intervistojë të gjithë komisionerët në këto vendvotime, gjithsejt 76. Në momentin e fillimit të intervistimit, procesi i numërimit të votave është stopuar. Në disa qendra dhe vendvotime janë ndërruar komisionerët, ndërsa për disa vendvotime ka pasur hezitim dhe keqkuptime ndërmjet PSh dhe KQZ-së se si të veprohet. Në momentin që kanë filluar intervistat e komisionerëve është paraqitur nevoja për ndërrimin e komisionerëve. Por, një e tillë nuk ka ndodhur në disa qendra. Për ndërrimin e komisionerëve, zyrtarët e KKZ-së në Skënderaj kanë kërkuar që marrin urdhër nga prokurorët. Këta të fundit nuk kanë mandat të urdhërojnë ndërrimin e komisionerëve. Hezitimi i KQZ-së për të ndërruar komisionerët është parë nga prokurorët si përpjekje për të lënë fajtorë PSh-në për çfarëdo që ndodh rreth mbarëvajtjes së procesit të votimit në këto qendra.⁴¹ Përfaqësuesit e KQZ-së këtë hezitim e kanë shpjeguar me mungesën e koordinimit në mes të prokurorit kujdestar të PTH të Mitrovicës dhe zyrtarit të KKZ-së në Skënderaj.⁴² Megjithatë, koordinimi në nivel qendror ka ndikuar që mos të thellohen problemet në zbatimin e detyrimeve ligjore në teren dhe mbarëvajtja e procesit të numërimit të votave ka shkuar si duhet, por ka pasur vonesa, për shkak kohës derisa janë intervistuar komisionerët nga pjesëtarët e policisë. Monitoruesi i IKD-së ka qenë prezent në AçaREVë dhe sipas monitorimit, rezulton se gjithçka ka shkuar në rregull në procesin e intervistimit të komisionerëve dhe në procesin e numërimit të votave.

IKD vlerëson se këto institucione duhet të jenë më efikase për të reaguar në situatat kur paraqitet nevoja e bashkëpunimit ndër-institucional me qëllim që mos të krijohen probleme që ndikojnë në mbarëvajtjen e procesit të zgjedhjeve. Hezitimi dhe mungesa e koordinimit ndërmjet prokurorisë, policisë dhe KQZ-së duhet të evitohet në të ardhmen. Për këtë qëllim është nënshkruar

bërë një urgjencë Drejtorit Rajonal të Policisë, z. Nehat Thaçi, i cili ka dërguar forca shtesë dhe gjithçka ka shkuar në rregull”, deklaratë e Kryeprokurorit të PTh në Mitrovicë, z. Shyqri Sylja, në emisionin e specializuar për fushën e sundimit të ligjit “Betimi për Drejtësi, të transmetuar drejtpërdrejtë dy ditë pas ditës së votimit rreth përgjigjes së organeve të drejtësisë në zgjedhjet parlamentare. Emisioni “Betimi për Drejtësi”, RTK1.10 qershor 2014 (shih <http://betimiperdrejtesi.com/emisionet/drejtesia-ne-zgjedhje/>)

⁴¹“Në vendin e ngjarjes jam informuar nga prokurori se KKZ në nivel lokal ka thënë se urdhërin për ndërrimin e komisionerëve e jep prokurori. Nuk është kështu sepse kjo është kompetencë e KQZ-së, prandaj ata nuk ka pas urdhëra nga prokurori për një gjë të tillë dhe nuk ka pas ndërrim të komisionerëve.. Është e vërtetë se komisionerët kanë qenë të gatshëm, por ata nuk janë ndërruar, pasi për ndërrimin e tyre, KKZ ka kërkuar urdhër të prokurorit, thjeshtë ka dashtë me ja lan fajin prokurorit”, deklaratë e Kryeprokurorit të PTh në Mitrovicë, z. Shyqri Sylja, në emisionin e specializuar për fushën e sundimit të ligjit “Betimi për Drejtësi, të transmetuar drejtpërdrejtë dy ditë pas ditës së votimit rreth përgjigjes së organeve të drejtësisë në zgjedhjet parlamentare. Emisioni “Betimi për Drejtësi”, RTK1.10 qershor 2014 (shih <http://betimiperdrejtesi.com/emisionet/drejtesia-ne-zgjedhje/>).

⁴²“Ka pasur mungesë të koordinimit në mes të prokurorit kujdestar të PTH të Mitrovicës dhe zyrtarit të KKZ-së në Skënderaj sepse ne në qendër kemi të koordinuar, pasi kemi pasur një qendër komanduese ku kanë qenë përfaqësuesit e të gjitha institucioneve të drejtësisë dhe ne kemi pasur numrin e mjaftueshëm të komisionerëve, të cilët i kemi ofruar, por nuk ka pasur nevojë që të bëhet ndërrimi i tyre”, deklaratë e z. Xhemal Peçani, zyrtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në emisionin e specializuar për fushën e sundimit të ligjit “Betimi për Drejtësi, të transmetuar drejtpërdrejtë dy ditë pas ditës së votimit rreth përgjigjes së organeve të drejtësisë në zgjedhjet parlamentare. Emisioni “Betimi për Drejtësi”, RTK1.10 qershor 2014 (shih <http://betimiperdrejtesi.com/emisionet/drejtesia-ne-zgjedhje/>).

Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet këtyre institucioneve dhe poashtu janë përgatitur Planet e Veprimi të koordinuara në mes tyre, ku janë përcaktuar obligimet që derivojnë nga ligji për secilin institucion. Mos respektimi i këtyre akteve padyshim se ndikon në shkeljen e dispozitave të caktuara të Memorandumit dhe ligjeve pozitive, që mund të kenë reflektim tejet negativ në mbarëvajtjen e procesit të zgjedhjeve.

d. Votimi më shumë se një herë apo për tjetrin

Monitorimi i IKD-së kishte identifikuar se në nëntë (9) raste dhe në katër (4) komuna të Kosovës, persona të ndryshëm kishin tentuar të votojnë me shumë se njëherë apo në emër të një personi tjetër.⁴³ Këto veprime të këtyre personave bëjnë pjesë në veprat penale kundër të drejtave të votimit. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, përkatësisht me nenin 216, ka paraparë dënim të ashpër me burgim efektiv deri në tre (3) vjet për personat që përfshihen për të votuar më shumë se njëherë apo nëse tenton të votojë në emër të dikujt tjetër.⁴⁴

Monitoruesi në Komunën e Graçanicës ka vërejtur se dy herë ishte tentuar të votohet në qendrën votuese nr. 3401e, në shkollën "Krajl Milutin". Në të njëjtën qendër, rreth orës 16:00, atëherë kur qendra kishte filluar të frekuentohet me shumë nga votuesit, monitoruesi i IKD-së kishte vërejtur se në pesë (5) raste, ishte tentuar të votohej dy (2) herë nga persona të ndryshëm. Gjatë monitorimit është vërejtur se mënyra e tentimit për të votuar më shumë, ishte e tillë që komisioneri i vendvotimit përkatës, kontrollonte vetëm njëherë dorë të këtyre personave me llambën me ndriçim ultraviolet. Fakti se monitoruesi i IKD-së ka qenë prezent në këtë vendvotim, ka ndikuar që këto votime të dyfishta të evitohen dhe të njëjtit persona të largohen për shkak të presionit të monitorimit.⁴⁵ Për këto tentime nuk kishte pasur njoftim të prokurorisë dhe policisë nga ana e zyrtarëve të angazhuar në këtë vendvotim, prandaj kanë munguar reagimet e këtyre institucioneve.

Dy herë ishte provuar të votohej edhe në Komunën e Shtërpçës, në qendrën votuese numër 2305d, në vendvotimin 2305d/01r, Shkolla Filllore "Osman Mani" në fshatin Firajë. Monitoruesi i IKD-së kishte identifikuar se rreth orës 11:30 minuta, një person pasi kishte votuar me parë, ishte paraqitur përsëri me familjen e tij dhe kishte provuar të futet prapë, i cili me pas ishte

⁴³ Monitoruesit e IKD-së kanë identifikuar disa raste ku persona të ndryshëm kanë tentuar të votojnë më shumë se njëherë dhe në emër të pesonave tjerë. Këto raste janë identifikuar në Komunën e Mitrovicës, Shtërpçës, Graçanicës dhe Fushë Kosovës.

⁴⁴ Neni 216 - "Keqpërdorimi i të drejtës së votimit": 1. Kushdo që kryen një ose më shumë nga veprat në vijim, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet: 1.1. voton ose tenton të voton në emër të personit tjetër; 1.2. voton ose tenton të voton edhe pse ka votuar një herë; ose 1.3. shfrytëzon më shumë se një listë votimi. Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

⁴⁵ *Shënim:* Sipas monitoruesit të IKD-së, personat e njëjtë kishin tentuar disa herë të votonin më shumë se njëherë. Këtë tentim ata ishin munduar ta bënin vazhdimisht, sidomos veprimet e tyre kanë qenë të shprehura në momentet kur monitoruesi ka bërë lëvizje brenda vendvotimit. Duke parë këto tentime, monitoruesi i IKD-së vazhdimisht ka kryer detyrimin e tij të monitoruesit, duke evidentuar secilin tentim në fletoren e tij. Fakti se çdo gjë rreth tentimit të tyre është evidentuar nga monitoruesi.

arsyetuar se do të asistonte për familjarët. E njëjta gjë ishte evituar nga drejtuesit e vendvotimit, të cilët kishin konsideruar të panevojshëm ndërhyrjen e policisë.⁴⁶

Në Qendrën e Votimit 0101x, në Deçan, kishte ndodhur një rast tentim-votimi për personin tjetër. Shqetësues ishte fakti se kryesuesi i vendvotimit, fillimisht ishte pajtuar që personi në fjalë të votojë për tjetrin. Mirëpo reagimi i komisionerëve tjerë kishte penguar votimin për tjetrin, me ç'rast edhe prokuroria ishte njoftuar dhe kishte reaguar menjëherë.⁴⁷

Më shumë se njëherë ishte tentuar të votohej në komunën e Fushë Kosovës. Në vendvotimin 0901X-01R në Shkollën Fillore "Mihail Grameno", pasi llamba me ndriçimin ultraviolet kishte shënjuar në gishtërinjtë e një votuese, ishte dyshuar se personi i tillë kishte votuar më parë dhe kështu policia kishte reaguar menjëherë duke marrë në pyetje të dyshuarën.

Policia ka reaguar me urgjencë në një rast tjetër në Mitrovicë, me ç'rast një person ishte arrestuar për faktin se i njëjti kishte tentuar të votonte më shumë se një herë. Me urdhër të prokurorit, të dyshimtit i ishte caktuar masa e ndalimit prej 48 orëve.⁴⁸

e. Pengimi i procesit votues

Monitoruesit e IKD-së gjatë vëzhgimit të procesit zgjedhor, kanë identifikuar prani të kandidatëve për deputet në afërsi të Qendrave të Votimit, gjithashtu prani militantëve nga subjektet e ndryshme politike të cilët tentonin të ndikonin në votues në forma të ndryshme. IKD ka vërejtur gjithashtu veprime tjera me të cilat tentohej të ndikohej në procesin zgjedhor.

Në Qendrën e Votimit 2306d në Shkollën Fillore "Sharski Odred" në Jazhincë – Shtërpcë, rreth orës 18:00 në ditën e votimit, është vërejtur një kandidate për deputete në afërsi të Shkollës. Pas njoftimit të Policisë së Kosovës, reagimi ka qenë i menjëhershëm, duke larguar kandidaten nga afërsia e Qendrës së Votimit.

Prania e militantëve nëpër qendrat e votimit ishte gjetje tjetër e gjatë monitorimit të procesit të zgjedhjeve nga monitoruesit e IKD-së.

Në komunën e Istogut, në qendrat e votimit 0608c në fshatin Rakosh, Shkolla Fillore "Ndre Mjeda" dhe në atë 0613c në fshatin Uçë, në Shkollën Fillore "Tre Dëshmorët", militantë të subjekteve të ndryshme politike ishin të pranishëm në oborret e të dyja shkollave, të cilët

⁴⁶ *Shënim:* Monitoruesi i IKD-së ka raportuar se rreth orës 11:30, në vendvotimin 2305D/01R, një person kishte tentuar të votoi më shumë se një herë. Personi në fjalë për herë të parë është paraqitur si i dehur në përcjellje të të ashtuquajtur vajzës së tij.

⁴⁷ *Shënim:* Rasti i dyshimtë kishte të bënte me një të moshuar, që kishte shkuar në votim së bashku me gruan e tij (e cila kishte dalë kohe më parë nga një operacion), mirëpo që gruaja kishte harruar letërnjoftimin në shtëpi dhe nuk iu kishte lejuar votimi pa dokument identifikimi. Personi në fjalë e ka dërguar gruan e tij në shtëpi dhe duke e ditur gjendjen shëndetësore të saj ka marrë letërnjoftimin e gruas dhe ka shkuar në Qendrën e Votimit duke tentuar që të votojë për gruan e tij.

⁴⁸ *Shënim:* IKD gjatë monitorimit në Qendrën e Votimit 1103x në Shkollën Fillore "Shaban Idrizi" ka monitoruar reagimin e policisë dhe prokurorisë. Në vendin e ngjarjes menjëherë kanë arritur pjesëtarët e policisë, të cilët kanë arrestuar personin që kishte tentuar të votonte dy herë. Të njëjtit person, siç është njoftuar monitoruesi nga prokurori kujdestar është ndaluar për 48 orë me urdhër të prokurorit.

përpiqeshin të ndikonin në votues. Sipas menaxherëve të shkollave, Policia e Kosovës ishte njoftuar për të dyja rastet, të cilët me pas kishin reaguar, duke larguar militantët nga afërsia e Qendrave të Votimit duke parandaluar kështu, ndikimet në procesin zgjedhor.

Rast i njëjtë kishte ndodhur edhe në Qendrën e Votimit 2407A në fshatin Gjinoc, Komuna Suharekë. Sipas menaxherit të shkollës, një grup i vogël i personave kishin qëndruar në oborrin e shkollës, duke tentuar të flisnin me votuesit e kësaj qendre, duke provuar kështu të ndikojnë në votuesit. Në këtë rast vetë menaxheri kishte reaguar duke biseduar me personat, të cilët më pas ishin larguar nga afërsia e Qendrës së Votimit.

Tentim për të ndikuar në votën e lirë ka pasur edhe në Komunën e Parteshit, përkatësisht në Qendrën e Votimit 3602D, Vendvotimi 3602D/02D në Shtëpinë e Kulturës. Sipas menaxherit të kësaj qendre, një person kishte provuar të ndikoj në votën e një qytetari, mirëpo me reagimin e zyrtarëve në Qendrën e Votimit dhe policisë, rasti ishte evituar.⁴⁹

Si pengim i procesit të votimeve ishte cilësuar edhe hapja me vonesë e Qendrës së Votimit 2063a në “Shtëpinë e Gjahtarëve” në Fshatin Sdreck në Prizren.

Sipas vëzhguesve të partive politike, zyrtarit të KQZ-së dhe kryesuesit të Qendrës së Votimit, Qendra e Votimit ishte hapur me 30 minuta vonesë pasi që zonja B. Z., nuk kishte dorëzuar çelësat e shkollës – Qendrës së Votimit - për tu përgatitur për procesin votues. Për këtë gjë, ajo ishte intervistuar edhe nga Policia, ndërsa pas 30 minutave, e njëjta kishte pranuar t’i jap çelësat e qendrës.⁵⁰

Prani të militantëve partiak kishte pasur edhe në afërsi të Qendrës së Votimit 2112b në Kladernicë të Komunës së Skënderajt. Sipas zyrtarëve të Qendrës së Votimit, afër qendrës votuese kishin qëndruar tre (3) persona të cilët kishin tentuar t’i pengojnë votuesit duke u munduar gjithashtu të ndikojnë në votuesit. Edhe në këtë rast, Policia e Kosovës kishte reaguar duke larguar penguesit nga afërsia e qendrës votuese.⁵¹

Rast tjetër i ndikimit në votues është ai në Qendrën e Votimit nr 3016a në Shkollën e Mesme “Hamdi Berisha” në Malishevë. Në byrektoren afër kësaj Qendre të Votimit, ishin kapur katër persona të cilët me fletëvotime në duar, kishin rrumbullakuar numrat që do të duhej të votoheshin nga votuesit të cilët i ndalonin afër Qendrës së Votimit. Pas intervistimit nga Policia e Kosovës, tre persona ishin liruar, kurse të katërtit, i ishte caktuar masa e paraburgimit.⁵²

⁴⁹ Monitoruesi i IKD-së në Komunën e Parteshit ka raportuar se reagimi i policisë ka qenë adekuat dhe në kohë për të evituar këtë rast.

⁵⁰ *Shënim:* Monitoruesi i IKD-së ka kontaktuar me Rreshterin e Policisë së Kosovës A. A., i cili ka konfirmuar rastin. Rreshteri ka njoftuar se ndaj zonjës, e cila penguar procesin e votimit është hapur rasti me nr. 1693, ndërsa pas marrjes së deklaratës dhe konsultimit me prokurorin, rasti është në procedurë të rregullt.

⁵¹ Monitoruesi i IKD-së ka raportuar se në këtë rast policia me tu njoftuar për praninë e këtyre personave ka reaguar për t’i larguar menjëherë.

⁵² Neni 112 par. 2 i KPK-së- Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar: “Kushdo që gjatë votimit ose referendumit, në mënyrë të kundërligjshme parandalon, pengon ose ndikon në përcaktimin e lirë të votuesit ose në

f. Të gjeturat teknike

Gjatë monitorimit të procesit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve, IKD kishte identifikuar gjithashtu probleme tjera të natyrës teknike që kishin shoqëruar ditën e zgjedhjeve.

Në komunën e Novobërdës dhe Podujevës, monitoruesit e IKD-së kishin identifikuar raste kur fletëvotimet nuk ishin vulosur fare nga zyrtarët përgjegjës të Qendrave të Votimit. Kjo kishte ndodhur në Vendvotimin 1401D/01D në Shkollën Filllore "Minatori" në Novobërde, në të cilën qendër, numërimi kishte rezultuar me 11 vota të pavlefshme dhe 1 votë të pa vulosur. E njëjta gjë kishte ndodhur gjithashtu në Podujevë në qendrën 1824E, në Shkollën "Isa Boletini". Në këtë rast, komisioneri i subjektit Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), nuk kishte vulosur fletëvotimet në mënyrën e duhur dhe pasi ishte vërejtur nga zyrtarët tjerë në vendvotim, të njëjtit iu kishte tërhequr vërejtja i cili më pas, kishte vazhduar të vulosë në mënyrën e duhur.

Mungesa e fletëvotimeve, problemet me emra në listën e nënshkrimeve dhe ndërprerja e energjisë elektrike ishin të gjeturat tjera të identifikuara nga monitoruesit e IKD-së.

Në komunën e Drenasit, monitoruesi i IKD-së kishte identifikuar mungesën e fletëvotimeve në disa Qendra të Votimit. Në Shkollën "Xheladin Gashi – Plaku", në Qendrën e Votimit 0302e, kishin munguar rreth 224 fletëvotime të cilën gjë kishte konfirmuar gjithashtu menaxheri i shkollës dhe për të cilën gjë, kishte njoftuar organet kompetente. Numër të pamjaftueshëm të fletëvotimeve ishin identifikuar edhe në komunën e Rahovecit.

E gjetur tjetër teknike ishte ndërprerja e energjisë elektrike. Kjo kishte ndodhur në komunën Han Elez, me ç'rast në qendrën e votimit numër 3303d në Shkollën Filllore "Veli Bllazi" në fshatin Gorancë, energjia elektrike ishte ndërprerë në ora 22:08 minuta, gjatë numërimit të votave. Kjo kishte shkaktuar ndërprerjen e procesit të numërimit dhe pas më shumë se 30 minuta, përkatësisht në ora 22:45, kishte rifilluar numërimi i votave.

Problemet me emrat në lista kishin shoqëruar edhe zgjedhjet e 8 qershorit. Kësaj herë, ishte mungesa e emrit në listën e nënshkrimeve me arsyetimin se personi në fjalë kishte vdekur. Kjo kishte ndodhur në fshatin Zahaq të Pejës, përkatësisht në shkollën fillore "Haxhi Zeka" në qendrën e votimit 1708c. Gjatë monitorimit në këtë qendër, dhe gjatë bisedës me vëzhguesit tjerë, ishte vërejtur se një person është ankuar se nënën e kishte të gjallë, kurse në librin e nënshkrimit ajo ishte e vulosur si e vdekur. Kjo kishte ndodhur në vendvotimin me numër 1708c/03R.⁵³

ndonjë mënyrë tjetër pengon personin tjetër në ushtrimin e së drejtës së tij për të votuar, dënohet me burgim deri në një (1) vit).

⁵³*Shënim:* Gjatë kohës së monitorimit personi që në librin e nënshkrimeve konsiderohej i vdekur, ka shkuar në vendvotim për të votuar. Personi në fjalë quhej F. M., e lindur në vitin 1932 në fshatin Nakëll të komunës së Pejës. F. M. e ndihmuar nga djali dhe nusja e saj ka votuar dhe e njëjta u nënshkrua mbi vendin ku ishte i vulosur. N. R. komisioneri që ishte caktuar për librin e votimit (nënshkrimeve) deklaroi se çdo e dhënë e F. M përputhej me të dhënat që ishin në vendin ku ishte vulosur, dhe se pas verifikimit ai në pajtim me të gjithë komisionerët kanë vendosur se ajo duhet të votojë.

7. Trajtimi i rasteve të zgjedhjeve të vitit 2013 dhe 2010

Trajtimi i rasteve të zgjedhjeve është caktuar si prioritet i organeve të drejtësisë. Ky prioritet është vendosur në Memorandumin e Bashkëpunimit të nënshkruar në mes të institucioneve të drejtësisë. Në praktikë nuk rezulton se këto raste janë duke u trajtuar me prioritet. Të dhënat e KPK-së tregojnë se as gjysma e personave të përfshirë në manipulimin e zgjedhjeve lokale 2013 nuk janë zgjidhur. Për këto zgjedhje vetëm në ditën e votimit ishin inicuar 54 raste ndaj 118 personave, ndërsa pas ditës së votimit, KQZ kishte parashtruar në PSh edhe 143 kallëzime të reja penale ndaj 143 personave. Për më tepër shih tabelën 3.

Zgjedhjet Lokale 2013	Kallëzime penale	Persona
Kallëzime penale gjatë ditës së votimit	54	118
Kallëzime penale pas ditës së votimit	143	143
Total:	197	261

Tabela 4 – Numri i kallëzimeve penale dhe personave të përfshirë në manipulimin e zgjedhjeve 2013

Siç vërehet në tabelën më lartë, personat e përfshirë në kryerjen e veprave penale që ndërlihen me të drejtat e votimit, mund të ndiqen edhe pas kryerjes së ditës së votimit. KQZ ka parashtruar 143 kallëzime penale ndaj personave, të cilët kishin votuar dy herë. Votimi i dyfishtë ishte kryer në atë mënyrë që këta persona, kishin shfrytëzuar njëherë të drejtën e rregullt për të votuar, ndërsa më pas kishin votuar edhe me kusht në Qendra tjera të Votimit. Ky veprim konsiderohet votim i dyfishtë dhe hyn në sferën kriminale në kuadër të veprave penale kundër të drejtave të votimit, e cila ndiqet zyrtarisht nga prokurorët.

Prej këtyre rasteve të inicuar rreth zgjedhjeve lokale 2013 prokurorët në afat rekord kanë ngritur një numër aktakuzash dhe poashtu në afat rekord janë shqiptuar disa dënime për këto raste nga gjykatat. Shih tabelën 5 për vendimet e prokurorëve dhe gjykatësve për këto raste.

Rastet e Zgjedhjeve Lokale 2013	Total:	Aktakuza	Pushim Hetimeve	Aktgjykim Lirues	Aktgjykim-Dënim me Kusht	Dënim me burg dhe gjobë
Aktakuza	32	32				
Persona	48	48	1	1	1	1
Total:	48	48	1	1	1	1

Tabela 5 – Vendimet e prokurorëve dhe gjykatësve për rastet e zgjedhjeve 2013

Prokurorët siç shihet kanë ngritur 32 aktakuza ndaj 48 personave të përfshirë në kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit. Një rast është pushuar, ndërsa janë disa aktgjykime të shpallura nga gjykatësit në lidhje me këto aktakuza. Një aktgjykim është lirues ndaj 1 personi, një aktgjykim me dënim me kusht ndaj 1 personi dhe një aktgjykim me dënim kumulativ me gjobë dhe burgim efektiv ndaj 1 personi.

Trajtimi i rasteve të zgjedhjeve të vitit 2010 për të cilat kishte numër enorm të komisionerëve të akuzuar në kryerjen e veprave penale, gjithsejt mbi 1500 komisionerë, ka pësuar ngecje në sistemin gjyqësor.

Vendimet e gjykatave	Numri i aktakuzave të zgjidhura	Numri i aktakuzave të pazgjidhura
Dënim me burgim	30	
Dënim me gjobë	35	
Dënim me kusht	19	
Dënime tjera	1	
Aktgjykim lirues	5	
Aktgjykim refuzues	4	
Zgjidhur në mënyrë tjetër	3	
Total:	97	135

Tabela 6 – Vendimet e gjykatave për rastet e zgjedhjeve 2010

Të dhënat e prezantuara në tabelën 6 janë të dhënat e fundit të siguruar nga IKD prej Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këto të dhëna nuk janë të azhurnuara sepse ka raste të reja të zgjedhjeve të zgjidhura nga gjykatësit, por të cilat nuk janë siguruar nga zyrtarët e KGJK-së.⁵⁴ Këto të dhëna dëshmojnë se numri i rasteve të zgjidhura për zgjedhjet e vitit 2010 mbetet ende shqetësues, pasi as gjysma e rasteve nuk kanë arritur të zgjidhen.

⁵⁴ IKD ka adresuar kërkesa për qasje në të dhënat e fundit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës sa i përket trajtimit të rasteve të zgjedhjeve nga gjykatat, por një përgjigje e tillë nuk është kthyer nga zyrtarët e këtij institucioni. Komunikim gjatë muajit korrik dhe gusht 2014 përmes emailave dhe telefonit me zyrtarët e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

8. Rekomandimet

IKD ka nxjerrë rekomandimet në vazhdim, të cilat do të kontribuonin avancimin e ndjekjes dhe gjykimit të rasteve që ndërlidhen me veprat penale kundër të drejtave të votimit:

- Institucionet që janë nënshkrues të Memorandumit të Bashkëpunimit “Lidhur me zgjedhjet e vitit 2013” dhe memorandumit “Lidhur me zgjedhjet parlamentare 2014”, duhet të respektojnë me përpikëri obligimet që kanë marrë për trajtimin me prioritet të rasteve që ndërlidhen me zgjedhjet deri në zgjidhjen e rastit të fundit .
- Institucionet që janë nënshkruese të Memorandumit të Bashkëpunimit, duhet të shkëmbejnë përvojat dhe mësimet e nxjerra nga këto zgjedhje dhe zgjedhjet lokale të vitit 2013 ashtu që të identifikojnë mangësitë dhe praktikat e mira për t’i adresuar në avancimin e akteve juridike dhe zbatimin e praktikave më të mira në zgjedhjet e ardhshme.
- Institucionet e drejtësisë duhet të avancojnë aktet normative rreth rregullimit të procedurave dhe përcaktimit të detajuar të përgjegjësisë të zyrtarëve të ndryshëm në procesin zgjedhor.
- Institucionet e drejtësisë duhet të avancojnë mënyrat e komunikimit ndërinstytucional në mënyrë që të shtohet efikasiteti në të gjitha rastet që paraqiten rreth zgjedhjeve.
- Institucionet e drejtësisë duhet të vazhdojnë me praktikën e mira të ndërtuar për sensibilizimin e opinionit rreth mundësive të bashkëpunimit me organet e drejtësisë si dhe edukimi i tyre rreth rreziqeve dhe pasojave juridike në rast të përfshirjes në kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit.
- Institucionet e drejtësisë bazuar në mandatin e tyre duhet të sensibilizojnë qytetarët rreth adresave të sakta se ku duhet të lajmërohen rastet e keqpërdorimeve të zgjedhjeve, duke eliminuar keqkuptimet me adresat tjera të organizatave jo-qeveritare.
- PSh dhe PK duhet të vazhdojë me avancimin e PSV-ve duke u bazuar në praktikën dhe mësimet e nxjerra gjatë zbatimit të PSV-ve gjatë dy procese të fundit të zgjedhjeve në Kosovë. Gjithnjë, duke pasur kujdes respektimin e kornizës ligjore për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe konventat ndërkombëtare.
- PSh dhe PK duhet të zhvillojnë hetime në drejtim të sigurimit të elementeve të krimit të organizuar, duke ndjekur organizatorët e kryesve të krimeve të zgjedhjeve.
- PSh duhet të hetoj dyshimet e vazhdueshme të ngritura rreth mënyrës së financimit të partive politike dhe shpenzimeve të këtyre partive politike.
- Gjykatësit duhet të trajtojnë me prioritet lëndët e zgjedhjeve. Gjithashtu, gjykatësit sugjerohen të kuptojnë shkallën e rrezikshmërisë, rëndësinë e zgjedhjeve dhe veprave penale kundër të drejtave të votimit dhe të shqiptojnë masa adekuate ndaj të pandehurve.
- Organet e ndjekjes duhet të avancojnë metodat e hetimit dhe të eliminojnë format e ndërlikuara të krimeve, që përfundimisht të eliminohen format e drejtpërdrejta dhe ato të tërthorta të kushtëzimit të votimit.